

20120110314

L I G J
PËR PAGESE TË PENSIONEVE DHE KOMPENSIMEVE PENSIONALE NGA
SIGURIMI PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Pjesa I

Kreu I
Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Lenda

Me kete ligj rregullohet menyra e pageses së pensioneve nga sigurimi i detyrueshem pensional me financim kapital (në tekstin e metejme: shtylla e dyte) dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi vullnetar pensional me financim kapital (në tekstin e metejme: shtylla e trete).

Neni 2

Nocione

Shprehje të caktuara të perdorura në kete ligj e kane kuptimin si vijojne:

1. "Anetar i fondit pensional" eshte personi që ka llogari individuale në fondin e detyrueshem pensional dhe nuk ka realizuar pension nga sigurimi i detyrueshem pensional me financim kapital ose ka llogari vullnetare individuale dhe/ose profesionale në fondin pensional vullnetar dhe nuk ka realizuar kompensim pensional nga sigurimi vullnetar pensional me financim kapital;
2. "Shfrytezues i pensionit" eshte personi që ka realizuar pension nga shtylla e dyte ose kompensim pensional nga shtylla e trete;
3. "Shoqeri e sigurimit" eshte shoqeria e sigurimit që ka leje nga Agjencia për Supervizion të Sigurimit për kryerjen e puneve të sigurimit në klasen e sigurimit të anuiteteve dhe paguan anuitete për shfrytezuesit e pensionit;
4. "Shoqeri pensionale" eshte shoqeria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale dhe/ose shoqeria për menaxhim me fondet pensionale vullnetare dhe/ose shoqeria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare;
5. "Police" eshte marreveshje për pagesen e anuitetit të lidhur ndermjet shoqerise së sigurimit dhe shfrytezuesit të pensionit;
6. "Anuitet" eshte lloj i pageses së pensionit ose kompensimit pensional që paguhet në muaj nga shoqata e sigurimit, shfrytezuesit të pensionit ose shfrytezuesit të caktuar prej tij;
7. "Anuitet i perhershëm" eshte lloj i anuitetit me të cilin shoqeria e sigurimit i garanton shfrytezuesit të pensionit pagese të perhershme, mujore të pensionit ose kompensimit pensional, pa dallim të jetegjatesise së tij reale;
8. "Anuitet i perkohshëm" eshte lloj i anuitetit me të cilin shoqeria e sigurimit i garanton shfrytezuesit të pensionit pagese të pensionit ose kompensimit pensional për numrin e definuar paraprakisht të periudhave;
9. "Anuitet individual" eshte lloj i anuitetit të cilin shoqeria e sigurimit ia paguan vetem një shfrytezuesi të pensionit;
10. "Anuitet i perbashket" eshte lloj i anuitetit të cilin shoqeria e sigurimit ia paguan shfrytezuesit të pensionit, ndersa pas vdekjes së tij shfrytezuesit të caktuar nga ai;
11. "Anuitet i drejtperdrejte" eshte lloj i anuitetit të cilin shoqeria e sigurimit fillon ta paguaje jo më vone se muaji i cili pason pas muajit në të cilin premia eshte bartur nga ana e shoqerise pensionale në shoqerine e sigurimit;

12. "Anuitet i prolonguar" është lloj i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit fillon ta paguaje në muajin që pason pas muajit në të cilin perfundon periudha e prolongimit. Periudha e prolongimit matet me muaj dhe fillon në muajin në të cilin premia është bartur nga ana e shoqërisë pensionale në shoqërinë e sigurimit;

13. "Anuitet me periudhë të garantuar" është lloj i anuitetit që ka periudhë të definuar paraprakisht të muajve në të cilët detyrimisht do të paguhet pa dallim nëse shfrytëzuesi i pensionit është i gjallë. Nëse shfrytëzuesi i pensionit vdes, shoqëria e sigurimit ia paguan anuitetin shfrytëzuesit të caktuar deri në fund të periudhës së garantuar. Lartësia e anuitetit që e pranon shfrytëzuesi i caktuar është e barabartë me lartësinë e anuitetit që e ka pranuar shfrytëzuesi i pensionit. Shoqëria e sigurimit fillon ta paguaje anuitetin jo më vonë se nga muaji i cili pason pas muajit në të cilin premia është bartur nga ana e shoqërisë pensionale në shoqërinë e sigurimit;

14. "Anuitet pa periudhë të garantuar" është lloj i anuitetit që nuk ka periudhë të definuar paraprakisht të muajve në të cilët paguhet detyrimisht dhe paguhet deri sa shfrytëzuesi i pensionit është i gjallë. Shoqëria e sigurimit fillon ta paguaje anuitetin jo më vonë se nga muaji i cili pason pas muajit në të cilin premia është transmetuar nga ana e shoqërisë pensionale në shoqërinë për sigurim;

15. "Anuitet fiks" është lloj i anuitetit që paguhet në muaj në shumë fikse të shprehur në denare ose në euro në kundërvlerë me denare;

16. "Anuitet fiks i harmonizuar me shpenzimet për jetesë" është lloj i anuitetit i harmonizuar me qarkullimin e shpenzimeve për jetesë dhe paguhet në muaj në denare ose në euro në kundërvlerë me denare;

17. "Anuitet fiks me pjesëmarrje në fitim" është lloj i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit e paguan në muaj dhe që përfshin pagesë të garantuar minimale dhe përqindje nga fitimi i realizuar i shoqërisë së sigurimit;

18. "Anuitet variabel" është lloj i anuitetit që shoqëria e sigurimit e paguan në muaj me lartësi të ndryshueshme të anuitetit varesisht nga vlera në treg e mjeteve të fondit investues. Anuiteti shprehet në njësi ose pjesëmarrje të fondit investues, ndërsa lartësia e pensionit caktohet si rezultat i numrit të njësive (pjesëmarrjeve) dhe vlerës në treg të njësive (pjesëmarrjes);

19. "Terheqje të programuara" janë lloj i pagesës së pensionit ose kompensimit pensional që në muaj i paguan shoqëria pensionale deri në fund të jetesës, ose deri sa ka mjete në llogarinë e anëtarit të fondit pensional. Lartësia e terheqjeve të programuara për herë të parë llogaritet në momentin e realizimit të pensionit ose kompensimit pensional dhe rillogaritet në çdo 12 muaj nga shoqëria pensionale. Pagesa e terheqjeve të programuara ndërpritet me shfrytëzimin e mjeteve në llogarinë individuale, llogarinë vullnetare individuale ose profesionale të shfrytëzuesit të pensionit. Nëse shfrytëzuesi i pensionit vdes, mjetet e mbetura trashëgohen në pajtim me ligjin;

20. "Terheqje të parakohshme të programuara në kombinim me anuitet të përhershëm të prolonguar" është lloj i pagesës së pensionit ose kompensimit pensional që fillon me pagesën e terheqjeve të programuara gjatë numrit të caktuar paraprakisht të viteve dhe vazhdon me anuitet të përhershëm të prolonguar. Periudha e prolongimit të pagesës së mjeteve për anuitet është e barabartë me periudhën e pagesës së terheqjeve të perkohshme të programuara dhe shprehet si numer i plote i viteve ose numer i pjesëtueshem me 12 muaj. Zgjedhja e terheqjeve të programuara të perkohshme dhe anuitetit të prolonguar bëhet në të njëjtën kohë;

21. "Pagesë e njëhershme" është terheqja e njëhershme e të gjitha mjeteve nga llogaria vullnetare individuale ose profesionale e anëtarit të fondit pensional dhe

22. "Pagesë e shumëhershme" është terheqja e mjeteve nga llogaria vullnetare individuale ose profesionale e anëtarit të fondit pensional në disa keste të njëjta ose të ndryshme në periudha të njëjta ose të ndryshme, deri sa nuk harxhohen mjetet në llogari. Me kestin e fundit paguhet të gjitha mjetet nga llogaria. Gjatë përcaktimit të shumave, numrit dhe periudhave të pagesave nuk shfrytëzohen tabela të vdekshmerisë.

Pjesa II
Pensione nga sigurimi i detyrueshem pensional
me financim kapital

Kreu 2
Pagesat e pensioneve të shtylles së dyte

Neni 3

Llojet e pagesave të pensioneve të shtylles së dyte

(1) Shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale pensionin e shtylles së dyte e paguajnë vetëm me shfrytezimin e një prej llojeve të pagesave në vijim, me zgjedhje të anetarit të fondit pensional:

- a) anuitet i drejtperdrejte i perhershëm;
- b) terheqje të programuara dhe
- v) terheqje të programuara të perkohshme në kombinim me anuitet të prolonguar të perhershëm.

(2) Anuiteti nga paragrafi (1) pikat a) dhe b) të këtij neni mund të jete fiks i harmonizuar me shpenzime për jetese ose me pjesëmarrje në fitim. Varesisht nga periodha e pageses anuiteti mund të jete i garantuar apo i pagarrantuar.

Neni 4

Ndryshimi i llojit të pageses së pensionit

(1) Polica për anuitet është marreveshje e pashkeputshme. Shoqeria e sigurimit nuk guxon ta nderprese policen për anuitet, as në raste pelqimi nga shfrytezuesi i pensionit.

(2) Shfrytezuesi i pensionit mund t'i zevendesoje terheqjet e perhershme të programuara të siguruara nga një shoqeri pensionale me shfrytezimin e mjeteve të mbetura në disponim nga llogaria individuale për blerjen e terheqjeve të perhershme të programuara nga shoqeri tjetër pensionale, blerjen e anuitetit të perhershëm nga shoqeria e sigurimit ose me blerjen e terheqjeve të perkohshme të programuara të kombinuara me anuitet të perhershëm të prolonguar.

(3) Nese shfrytezuesi i pensionit ka zgjedhur terheqje të perkohshme të programuara në kombinim me anuitet të perhershëm të prolonguar në çdo moment mund t'i zevendesoje terheqjet e perkohshme të programuara të siguruara nga një shoqeri pensionale me shfrytezimin e mjeteve të mbetura në disponim nga llogaria individuale, për blerjen e terheqjeve të perkohshme të programuara nga shoqeri tjetër pensionale për periodhen e mbetur. Polica për anuitetin e prolonguar nuk mund të nderpritet.

(4) Agjencia për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital (në tekstin e metejme: MAPAS) e percakton menyren e ndryshimit të terheqjeve të programuara dhe ndryshimin në lloj tjetër të pageses së pensionit.

Kreu 3
Rregulla për anuitete

Neni 5

Anuiteti i garantuar

(1) Nese anuiteti është i garantuar, shfrytezuesi i pensionit në policen për anuitet cakton shfrytezues i cili në rast të vdekjes së tij do ta shfrytezoje anuitetin deri në fund të periudhes së garantuar.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, shfrytezuesi i pensionit në policen për anuitet mund të caktojë më teper shfrytezues dhe radhe të shfrytezimit në rast të vdekjes, që do ta shfrytezojnë anuitetin deri në fund të periudhes së garantuar.

(3) Periudha e garantuar për anuitet është me kohezgjatje prej më së shumti 240 muaj.

Neni 6

Anuiteti fiks i harmonizuar me shpenzimet për jetese

(1) Shoqëria e sigurimit është e obliguar që të bëjë harmonizim periodik të lartësise së pensionit përmes anuitetit fiks të harmonizuar me shpenzimet për jetese në një prej dy menyrave në vijim:

a) sipas rritjes së indeksit të shpenzimeve për jetese në gjysmëvjetorin paraprak në raport me gjysmëvjetorin që i paraprin në Republikën e Maqedonisë, më 1 janar dhe 1 korrik çdo vit ose

b) harmonizim nominal fiks, së paku më 1 janar dhe 1 korrik për çdo vit. Përqindja e harmonizimit caktohet në ditën e blerjes së policës për anuitet, dhe është e pandryshueshme gjatë kohezgjatjes së policës. Në fund të çdo viti, Agjencia për Supervizion të Sigurimit (në tekstin e mëtejme: ASS) me pelqim paraprak të MAPAS-it, e përcakton përqindjen minimale të harmonizimit nominal për anuitetet fikse të cilat do të shiten gjatë vitit të ardhshëm kalendarik. Përqindja minimale e harmonizimit nominal zbatohet për të gjitha policat për këto lloje të anuiteteve që do të shiten gjatë vitit të ardhshëm, në nivel vjetor nuk mund të jete më e vogël se 1% e as më e madhe se 3%. Shoqëritë e sigurimit mund të ofrojnë përqindje më të lartë të sigurimit nominal, por nuk mund të ofrojnë përqindje që është më e ulët se përqindja minimale e përcaktuar nga ASS-ja për çdo vit kalendarik.

(2) ASS-ja me pelqim paraprak të MAPAS-it e përcakton mënyrën e harmonizimit me shpenzimet për jetese për pensionet e shtyllës së dytë të cilat paguhen përmes anuiteteve në fund të çdo viti. Përqindja minimale e harmonizimit nominal për policat me harmonizim nominal fiks, që do të shiten në vitin e ardhshëm kalendarik, shpallet në ueb faqen e ASS-së.

Neni 7

Subjekte përmes të cilave mund të shiten anuitete

(1) Policat për anuitete për shtyllën e dytë i shesin shoqëritë e sigurimit. Shoqëritë e sigurimit policat për anuitete i shesin përmes përfaqësuesit në sigurim, shoqërisë për përfaqësim në sigurim dhe shoqërisë brokëre të sigurimit, që është themeluar dhe punon në pajtim me Ligjin për supervizion të sigurimit.

(2) Shoqëria e sigurimit, përfaqësuesi në sigurim, shoqëria për përfaqësim në sigurim dhe shoqëria brokëre e sigurimit gjatë shitjes së anuiteteve, nuk guxon t'i ofrojë lirime, kthime të mjeteve në para ose volitshmeri të tjera anëtarit të fondit pensional.

Neni 8

Provizioni për shitje të anuiteteve

(1) Subjektet nga neni 7 i këtij ligji për shitjen e anuiteteve i arketojnë shërbimet e tyre në formë të rrogës ose provizionit dhe nuk guxojnë t'i arketojnë nga shfrytëzuesi i pensionit ose nga anëtarit i fondit pensional.

(2) Shuma më e lartë e provizionit për shitjen e anuitetit për shtyllën e dytë që mund të arkëtohet nga shoqëria e sigurimit është 2,5% e premise.

Neni 9

Përcaktimi i shumës së anuiteteve

(1) Shoqëria e sigurimit e përcakton shumën e anuiteteve, vendos për tabelat e vdekshmerisë, për parakushtet për shkallën e kamatës, për shpenzimet për menaxhim dhe parakushtet tjera që shfrytëzohen gjatë përcaktimit të lartësise së pensionit të ofruar.

(2) Gjatë përcaktimit të shumës së anuitetit të prolonguar në kombinim me terheqjet e programuara të perkohshme, shoqëria e sigurimit është e obliguar që ta përcaktojë shumën në atë mënyrë që një pjesë e mjeteve të akumuluar në llogarë individuale të anëtarit të fondit

pensional do t'i bartet shoqerise së sigurimit, ndersa pjesa tjetër mbetet në fondin pensional që të financohet pagesa e terheqjeve të programuara të perkohshme. Gjate percaktimit të pjeses që do të shfrytezohet si anuitet i prolonguar, shoqeria e sigurimit e merr parasysh raportin relativ ndermjet pensionit permes terheqjeve të perkohshme të programuara dhe pensionit permes anuitetit të prolonguar, si dhe kohezgjatjen e periudhes së prolongimit, të definuar nga shfrytezuesi i pensionit. Në oferten e shumes për anuitet, krahas lartesisë së pensionit permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe lartesisë së pensionit permes anuitetit të prolonguar, shoqeria e sigurimit e shenon shumen e mjeteve të akumuluar në llogarine individuale të anetarit që mbetet në fondin pensional dhe shumen që bartet në shoqerine e sigurimit. Shumat absolute të pensionit të percaktuar në atë menyre permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe pensionit permes anuitetit të prolonguar duhet t'i pergjigjen raportit relativ të pensionit permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe pensionit permes anuitetit të prolonguar.

Neni 10

Kompensime gjate pageses së anuiteteve

Shoqeria e sigurimit nuk guxon të arketoje kompensime gjate pageses së anuiteteve të shtylles së dyte, pervec shpenzimeve të transakcionit.

Neni 11

Percaktimi i lartesisë së pensionit permes anuitetit fiks me pjesemarrje në fitim

(1) Shoqeria e sigurimit është e obliguar që gjate llogaritjes së lartesisë së pensionit permes anuitetit fiks me pjesemarrje në fitim, të shfrytezoje simulime dhe projeksione me parametra dhe parakushte të lejuara.

(2) ASS-ja me pelqim paraprak të MAPAS-it i percakton parametrat e lejuar në lidhje me perqindjen e pjesemarrjes në fitim dhe të ardhurat që shoqerite e sigurimit dhe ndermjetesuesit e tyre mund t'i shfrytezojne në materialet për marketing, simulimet dhe projeksionet për lartesine e pensionit që në të ardhmen do të paguhet permes anuitetit fiks me pjesemarrje në fitim.

(3) ASS-ja me pelqim paraprak të MAPAS-it i percakton parakushtet që duhet të shfrytezohen dhe të theksohen nga ana e shoqerive të sigurimit, vecanerisht parakushtet lidhur me të ardhurat e mjeteve të investuara të shfrytezuara në disa "skenare", si: "bazik", "optimist", dhe "pesimist". Të ardhurat për "skenarin bazik" percaktohen në baze të performansave të portofolit nga mjetet me perberje të ngjashme të portofolit, që ofrohet në pajtim me policen për anuitet fiks me pjesemarrje në fitim, të realizuara së paku gjate 10 viteve të fundit. Në simulimet dhe projektimet krahas të ardhurave mesatare duhet të theksohet edhe variabiliteti i të ardhurave dhe pasojat nga variabiliteti i tille i lartesisë së pensionit, me atë që në skenarin "optimist" do të shfrytezohet parakushti për të hyra më të larta nga të hyrat e shfrytezuara në skenarin "bazik", ndersa në skenarin "pesimist" do të shfrytezohet parakushti për të hyra më të uleta nga të hyrat e shfrytezuara në skenarin "bazik".

(4) Shoqeria e sigurimit është e obliguar që gjate perllogaritjes së anuitetit fiks me pjesemarrje në fitim në simulimet dhe projeksionet pensionale, të perfshije shpenzime për punen e shoqerise së sigurimit dhe t'i shenoje në police. Lartesia e pensionit që i ofrohet shfrytezuesit të pensionit paraqitet në shume neto të zvogeluar paraprakisht për shpenzimet.

Neni 12

Ndryshimi i shumes së anuitetit pensional për shkak të ndryshimit të shumes së mjeteve në llogarine individuale

(1) Nese shuma e mjeteve nga llogaria individuale që barten nga shoqeria pensionale në shoqerine e sigurimit të zgjedhur nga anetari, dallohet nga shuma e anuitetit pensional për të cilin shoqerite e sigurimit kane dorezuar oferta paraprakisht, shoqeria e sigurimit e zgjedhur nga

anetari është e obliguar që në menyre proporcionale ta harmonizojë shumën e anuitetit që do të paguhet nga oferta e theksuar. Nëse shuma që bartet është më e madhe se shuma e theksuar në oferte, anuiteti në menyre proporcionale rritet, e nëse shuma e bartur është më e vogël se shuma e theksuar në oferte, anuiteti proporcionalisht zvogëlohet.

(2) Shoqëria e sigurimit mban evidence për të dhënat e shfrytëzuara për harmonizimin proporcional, në menyre të përcaktuar nga ASS-ja.

Neni 13

Të drejtat e vecanta për shfrytëzuesit e pensionit nga shtylla e dyte në rast të falimentimit ose likuidimit të shoqërisë së sigurimit

(1) Dispozitat e Ligjit për supervizion të sigurimit që kanë të bëjnë me falimentimin dhe likuidimin e shoqërisë së sigurimit në menyre perkatese zbatohen edhe në rast të falimentimit ose likuidimit të shoqërisë së sigurimit që siguron pension nga shtylla e dyte.

(2) Kërkesat e shfrytëzuesve të pensionit nga shtylla e dyte edhe nga personat e caktuar prej tyre, kanë të drejtë në përparësi të shlyerjes në krahasim me kreditorët tjerë të shoqërisë së sigurimit.

Kreu 4

Rregulla lidhur me terheqjet e programuara

Neni 14

Llojet e terheqjeve të programuara

(1) Shoqëria pensionale mund t'i ofrojë këto lloje të terheqjeve të programuara:

a) terheqje të programuara të përhershme, që mund të jenë produkt i pavarur dhe
b) terheqje të programuara të përkohshme, që mund të jenë vetëm në kombinim me anuitetin e prolonguar të përhershëm nga shoqëria e sigurimit.

(2) Shoqëria pensionale e paguan shumën e përgjithshme që mbetet në llogarinë individuale pas vdekjes së shfrytëzuesit të pensionit me terheqje të programuara, si trashëgimi, në pajtim me ligjin.

(3) Nëse në fund të periudhës së përkohshme për pagesën e terheqjes së programuar, në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit ka ende mjete, ato i paguhen shfrytëzuesit të pensionit si pagesë e fundit nga terheqjet e programuara të përkohshme. Nëse, mjetet në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit harxhohen para kalimit të periudhës së terheqjes, pagesa e terheqjeve të programuara të përkohshme ndërpritet.

Neni 15

Shoqëri për pagesën e terheqjeve të programuara

(1) Shoqëritë pensionale të themeluara në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital, mund të ofrojnë terheqje të programuara.

(2) Shoqëria pensionale është e obliguar që të caktojë person për llogaritjen dhe pagesën e pensioneve përmes terheqjeve të programuara. Llogaritje të pensioneve përmes terheqjeve të programuara mund të kryejë personi që ka leje si aktuar i autorizuar

(3) Personit nga paragrafi (2) i këtij neni leje i jep MAPAS-i.

Neni 16

Llogaritja dhe rillogaritja e pensioneve përmes terheqjeve të programuara

(1) Lartësia e pagesës së terheqjeve të programuara të përhershme për herë të parë llogaritet në ditën e realizimit të së drejtës së pensionit nga shtylla e dyte, ndërsa rillogaritet në çdo 12 muaj nga shoqëria pensionale.

(2) Gjate llogaritjes së pare të terheqjeve të programuara shoqëria pensionale është e obliguar që t'i shfrytëzojë keto parametra: shumën e përgjithshme të mjeteve në llogarinë individuale, faktorin e anuitetit për pension individual, moshën e shfrytëzuesit të pensionit dhe shkallën e tregut të të ardhurave.

(3) Gjate rillogaritjes së terheqjeve të programuara, shoqëria pensionale është e obliguar që t'i shfrytëzojë keto parametra: shumën e re të mjeteve në llogarinë individuale, faktorin e ri të anuitetit për pension individual, moshën e re të shfrytëzuesit të pensionit dhe kushtet e reja për shkallën e tregut të të ardhurave.

(4) Shoqëria pensionale është e obliguar që të shfrytëzojë formule për llogaritjen e pensionit mujor përmes terheqjeve të programuara të përhershme për muajin t , që paguhet gjatë 12 muajve në vijim dhe bazohet në pjesëtimin e shumës së përgjithshme të mjeteve në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit me faktorin që e paraqet kapitalin e nevojshëm për njësinë e pensionit dhe kjo shumë pjesëtohet me 12, në këto mënyre:

$$Pension_i_t = (Shuma_e_përgjithshme_t / Njesia_t) / 12$$

ku:

$Shuma_e_përgjithshme_t$ = Shuma e përgjithshme e mjeteve në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit në muajin t

$$Njesia_t = \text{Kapitali i nevojshëm për njësinë e pensionit në muajin } t$$

$$Pension_i_t = \text{Pensioni mujor që paguhet nga muaji } t \text{ deri në muajin } t + 11$$

(5) Formulën të cilën e shfrytëzon shoqëria pensionale për llogaritjen e kapitalit të nevojshëm për njësinë e pensionit, përmes terheqjeve të programuara të përhershme, ($Njesia_t$) është e barabartë me faktorin e anuitetit të aktuarit për anuitet të thjeshtë:

$$a_x = \sum_{t=1}^{w-x-1} {}_tE_x = \sum_{t=1}^{w-x-1} \frac{D_{x+t}}{D_x} = \frac{1}{D_x} * \sum_{t=1}^{w-x-1} D_{x+t}$$

(6) Faktori i anuitetit për anuitet të thjeshtë përfshin masë të probabilitetit që shfrytëzuesi i pensionit me të vertete ta përjetojë çdo vit të ardhshëm deri në fund të tabelës së vdekshmërisë dhe shkallë reale afatgjatë të të ardhurave.

(7) Formulën që e shfrytëzon shoqëria pensionale për llogaritjen e pensionit përmes terheqjeve të programuara të perkohshme për muajin t , që do të paguhet gjatë 12 muajve në vijim, bazohet në pjesëtimin e shumës neto të mjeteve në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit, pas zvogelimit të pjesës së shumës së mjeteve për financimin e anuitetit të prolonguar të përhershëm, me faktorin që e paraqet kapitalin e nevojshëm për njësinë e pensionit dhe pjesëtimin e kësaj shumë me 12, në këto mënyre:

$$Pension_i_t = (Shuma_neto_t / Njesia_t) / 12$$

ku:

$Shuma_neto_t$ = Shuma neto e mjeteve në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit në muajin t pas zvogelimit të premise për financimin e anuitetit të prolonguar të përhershëm

$$Njesia_t = \text{Kapitali i nevojshëm për njësinë e pensionit në muajin } t$$

$$Pension_i_t = \text{Pensioni mujor i cili do të paguhet nga muaji } t \text{ deri në muajin } t + 11$$

(8) Formulën që e shfrytëzon shoqëria pensionale për kapitalin e nevojshëm për njësi pensioni, përmes terheqjeve të programuara të perkohshme, ($Njesia_t$) është e barabartë me faktorin e anuitetit të aktuarit për anuitetin e perkohshëm të thjeshtë që fitohet gjatë n viteve të ardhshme, ku n është periudha e mbetur e prolongimit e shprehur në numër të viteve:

$$a_{x:n} = \frac{N_{x+1} - N_{x+n+1}}{D_x}$$

ku:

$$N_x = \sum_{i=1}^{w-x} D_{x+i}$$

(9) Faktori i anuitetit për anuitet të thjeshte të perkohshem perfsihin mase të probabilitetit që shfrytezuesi i pensionit me të vertete ta perjetoje çdo vit nga periodha e perkohshme dhe shkalle reale afatmesme të të ardhurave.

(10) Shoqeria pensionale për percaktimin e pensionit permes terheqjeve të programuara të perhershme dhe permes terheqjeve të programuara të perkohshme gjate 12 muajve në vijim detyrohet që t'i shfrytezoje shkallet e percaktuara nga paragrafi (9) i ketij neni.

Neni 17

Kompensime që arketohen për terheqjet e programuara

(1) Shoqerite pensionale arketojne kompensime nga shfrytezuesit e pensionit me terheqje të programuara të shtylles së dyte, në pajtim me nenin 98 paragrafi (1) pika b) të Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital.

(2) Shoqerite pensionale mund të arketojne shpenzime të transaksionit për pagesen e pensioneve permes terheqjeve të programuara.

Neni 18

Investimi i mjeteve që ruhen për terheqje të programuara

Shoqerite pensionale i investojne mjetet që i menaxhojne për llojet e terheqjeve të programuara të shtylles së dyte, në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital.

Neni 19

Garanci

Nese mjetet e fondit të detyrueshem pensional zvogelohen si rezultat i vepres penale mashtrim, vjedhje ose pervetesim, nga Buxheti i Republikes së Maqedonise paguhen mjete në fondin e detyrueshem pensional nga i cili paguhen pensioni në forme të terheqjeve të programuara, në proceduren e percaktuar me Ligjin për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital.

Kreu 5

Kombinimi i terheqjeve të programuara të perkohshme dhe anuitetit të prolonguar të perhershem

Neni 20

Kombinimi i terheqjeve të programuara të perkohshme dhe anuitetit të prolonguar të perhershem dhe ndarja e mjeteve

(1) Shfrytezuesi i pensionit mund t'i shfrytezoje mjetet e akumuluar në llogarine individuale për marrjen e dy llojeve të pageses së pensionit në kombinim: terheqje të programuara të perkohshme që i ofron shoqeria pensionale dhe anuitet të prolonguar të perhershem që e ofron shoqeria e sigurimit.

(2) Shfrytezuesi i pensionit duhet ta caktojë periodhen e terheqjeve të programuara të perkohshme, që duhet të harmonizohet me periodhen e prolongimit të anuitetit të prolonguar të perhershem dhe të jete numer i plote i viteve ose numer i pjesetueshem me 12 muaj.

(3) Shfrytezuesi i pensionit duhet ta caktoj raportin fillestar ndermjet pensionit permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe pensionit permes anuitetit të prolonguar të perhershme, me ç'rast ky raport nuk mund të jete më i madh se 1,5 / 1 dhe nuk mund të jete më i vogel se 0,65 / 1 për çdo shfrytezues të pensionit që ka të drejte për shume më të ulet të pensionit.

(4) Lartesia e pensionit permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe pensionit të shtylles së pare duhet të jete e barabarte ose më e madhe se shuma më e ulet e pensionit të percaktuar me ligj.

(5) Shoqeria e pensionit eshte e detyruar që të kryeje kontroll nese shuma e pensionit e percaktuar permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe pensionit të shtylles së pare, eshte e barabarte ose më e madhe se shuma më e ulet e pensionit të percaktuar me ligj. Nese keto kushte nuk plotesohen, shoqeria pensionale nuk do të pranoje terheqje të programuara të perkohshme në kombinim me anuitet të prolonguar dhe anetari doemos duhet të beje zgjedhje tjeter ose të filloje procedure të re të kuotave për pension të shtylles së dyte.

(6) Ndarja e mjeteve ndermjet shumes së pensionit permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe shumes së pensionit permes anuitetit të prolonguar, percaktohet permes kuotimit për anuitete nga ana e shoqerise së sigurimit, duke i marre parasysh shumen e pergjithshme të mjeteve në llogarine individuale, kohezgjatjen e periudhes së prolongimit dhe niveleve relative të të dyja pensioneve. Shoqerite e sigurimit që kryejne kuotim për terheqjet e programuara të perkohshme në kombinim me anuitetin e prolonguar, japin oferta të caktuara për çdo shoqeri pensionale nga e cila mund të sigurohen terheqje të programuara të perkohshme.

Kreu 6

Dispozitat e perbashketa për anuitete dhe terheqje të programuara

Neni 21

Pensione individuale

(1) Pensioni nga shtylla e dyte permes terheqjeve të programuara të perhershme, permes anuiteteve të perhershme dhe permes kombinimit të terheqjeve të programuara të perkohshme dhe anuiteteve të perhershme të prolonguara, mund të caktohet vetem për një person që eshte shfrytezues i pensionit.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1) i ketij neni, kur shfrytezuesi i pensionit zgjedh anuitet të garantuar, cakton më teper shfrytezues dhe radhe të shfrytezimit në rast të vdekjes, të cilet e shfrytezojne anuitetin deri në fund të periudhes se garantuar.

Neni 22

Tabelat e vdekshmerise dhe shkallet e kamates për pensione nga shtylla e dyte

(1) Standardet minimale dhe rregullat për caktimin e tabelave të vdekshmerise, i percaktojne ASS-ja dhe MAPAS-i në kushte të njejta për shoqerite e sigurimit dhe për shoqerite pensionale, duke i marre parasysh:

a) specifiken e popullates së perbere nga pensionistet që marrin pension permes anuitetit dhe shfrytezuesit e tyre dhe

b) permiresimin e jetegjatesise.

(2) ASS-ja i percakton rregullat dhe standardet minimale për llogaritjen e rezervave teknike, ndersa shoqeria e sigurimit eshte e detyruar për llogaritjen e rezervave për anuitetet të shfrytezoje tabela të vdekshmerise në pajtim me standardet minimale të percaktuara nga ASS-ja.

(3) MAPAS-i i percakton rregullat dhe standardet minimale për tabelat e vdekshmerise, ndersa shoqeria pensionale eshte e detyruar që për llogaritjen e faktorit të anuitetit për pensionet e shkalles së dyte permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe të perhershme, të shfrytezoje tabela të vdekshmerise në pajtim me standardet minimale të percaktuara nga MAPAS-i.

(4) Shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale mbajne evidence dhe të dhena statistikore për vdekshmerine faktike të shfrytezuesve të pensionit dhe jane të obliguar që të dhenat statistikore t'i dorezojne te ASS-ja dhe MAPAS-i në periudhe dhe forme të percaktuara nga ASS-ja dhe MAPAS-i.

(5) Standardet minimale dhe rregullat për percaktimin e shkalleve të kamates i percaktojne ASS-ja dhe MAPAS-i në kushte të njejta për shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale, duke i marre parasysh:

a) shkallen e kamates që shfrytëzohet për llogaritjen e rezervave, perkatesisht faktorit të anuitetit, që mund të jete më e madhe se shkalla mbizoteruese reale në tregut e të ardhurave të letrave debitore afatgjate me vlere dhe

b) shkallet reale afatgjate dhe afatmesme të të ardhurave bazohen në shkallet mbizoteruese nominale në treg të të ardhurave për instrumentet debitore afatgjate dhe afatmesme, të zvogeluara për vleresimin e shkalles së shpenzimeve për jetese për periudhat e njejta dhe për vleresimin e shkalleve të ardhshme mbizoteruese në treg për letrat debitore afatgjate me vlere të parrezikuara, të perfaqesuara në portofolin e fondeve pensionale dhe shoqerive të sigurimit.

(6) ASS-ja i percakton rregullat dhe standardet minimale për caktimin e shkalleve të kamates, ndersa shoqeria e sigurimit eshte e obliguar që për llogaritjen e rezervave për anuitete, të shfrytëzoje shkalle të kamates në pajtim me rregullat dhe standardet minimale të percaktuara nga ASS-ja.

(7) MAPAS-i i percakton rregullat dhe standardet minimale për caktimin e shkalleve të kamates, ndersa shoqeria pensionale eshte e detyruar që për llogaritjen e faktorit të anuitetit për pensionet e shtylles së dyte permes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe të perhershme, të shfrytëzoje shkalle të kamates në pajtim me rregullat dhe standardet minimale të percaktuara nga MAPAS-i.

Kreu 7

Qendra për sistem elektronik për kuote

Neni 23

Formimi i Qendres për Sistem Elektronik për Kuote

(1) Shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale të cilat paguajne pensione të shtylles së dyte dhe të trete, me marreveshje themelojne Qender për Sistem Elektronik për Kuote (në tekstin e metejme: Qendra për Kuote).

(2) Çdo shoqeri e ardhshme e sigurimit dhe shoqeri pensionale që do të paguaje pensione të shtylles dyte dhe të trete behet themelues e Qendres për Kuote.

(3) Qendra për Kuote nga paragrafi (1) i ketij neni themelohet si subjekt jofitimprures dhe fiton cilesi të personit juridik me regjistrimin në Regjistrin Qendror të Republikes së Maqedonise.

(4) Me Qendren për Kuote menaxhojne drejtorite. Drejtorin e zgjedhin shoqerite themeluese nga paragrafi (1) i ketij neni.

(5) Qendra për Kuote miraton Status për të cilin pelqim jep MAPAS-i.

(6) MAPAS-i kryen kontroll mbi punen e Qendres për Kuote.

(7) Menyren e kryerjes së kontrollit nga paragrafi (6) i ketij neni e percakton MAPAS-i.

Neni 24

Punet e Qendres për Kuote

Qendra për Kuote i kryen punet në vijim:

a) vendos dhe miremban softuer për lidhje elektronike të të gjitha shoqerive të sigurimit dhe shoqerive pensionale të cilat jane themelues të Qendres për Kuote;

b) pranon dhe evidenton kerkesa për kuote të dorezuara në forme elektronike nga shoqerite pensionale;

v) pranon dhe evidenton oferta për anuitete dhe terheqje të programuara të dorezuara nga shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale;

g) miraton tabela permbledhese me të gjitha oferta e marra për anetarin i cili ka dorezuar kerkese për kuote;

d) kryen pune që jane me interes të perbashket me shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale;

gj) miraton kodeks të sjelljes të shoqerive për sigurim dhe shoqerive pensionale në procesin e kuotizacionit;

e) bashkepunon me MAPAS-in dhe ASS-në për ceshtje nga sfera e realizimit të pensioneve të shtylles së dyte dhe kompensimeve pensionale të shtylles së trete dhe

zh) kryen edhe pune tjera në pajtim me kete ligj.

Neni 25

Financimi i Qendres për Kuote

(1) Mjetet për kryerjen e puneve të Qendres për Kuote i sigurojne shoqerite themeluese nga neni 23 paragrafi (1) i ketij ligji në baze proporcionale.

(2) Qendra për Kuote nuk guxon të arketoje kompensime nga anetaret e fondeve pensionale ose shfrytezuesit e pensionit ose kompensimit pensional të shtylles së dyte dhe të trete.

(3) Qendra për Kuote perpilon plan vjetor për pune dhe plan financiar vjetor dhe i dorezon te MAPAS-i më së voni deri më 31 dhjetor në vitin rrjedhes për vitin e ardhshem.

Neni 26

Librat afariste dhe raportet e Qendres për Kuote

(1) Qendra për Kuote mban libra tregtare dhe perpilon raporte vjetore dhe dokumente të kontabilitetit, në pajtim me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprofitabile.

(2) Qendra për Kuote perpilon llogari vjetore dhe raport vjetor për vitin afarist dhe i dorezon deri më 31 mars të vitit rrjedhes për vitin e kaluar.

Neni 27

Marreveshja për themelimin e Qendres për Kuote

Me marreveshjen për themelimin e Qendres për Kuote percaktohen:

a) punet të cilat i kryen;

b) menyra e financimit;

v) organizimi;

g) menaxhimi dhe vendosja;

d) aktet e pergjithshme të Qendres për Kuote;

gj) menyra e pranimit të shoqerive të reja bashkethemeluese;

e) dalja dhe perjashtimi i shoqerive themeluese dhe

zh) ceshtje tjera në lidhje me punen e Qendres për Kuote.

Kreu 8

Menyra dhe procedura e realizimit të së drejtes për pension sipas pleqerise nga shtylla e dyte

Neni 28

Fillimi i procedures për realizimin e të drejtes për pension sipas pleqerise

(1) Procedura për realizimin e të drejtes për pension nga shtylla e dyte fillon me parashtrimin e kerkeses së anetarit të fondit pensional për realizimin e të drejtes për pension sipas pleqerise, te Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikes së Maqedonise (në tekstin e metejshem: Fondi i SPIM-it).

(2) Pas procedures së zbatuar, Fondi i SPIM-it, dorezon kopje nga aktvendimi i miratuar me të cilin pranohet ose nuk pranohet e drejta e pensionit sipas pleqerise, te shoqeria pensionale që menaxhon me fondin pensional ku eshte anetar parashtruesi i kerkeses.

(3) Nese pas procedures së shkalles së dyte për aktvendimin ose procedures gjyqesore, miratohet aktvendim tjetër për të drejten e pensionit sipas pleqerise, Fondi i SPIM-it, serish eshte i obliguar që të dorezoje kopje të vendimit te shoqeria pensionale nga paragrafi (2) i ketij neni.

Neni 29

Pjesemarrja e detyrueshme e anetarit të fondit pensional

(1) Qendra për Kuote eshte e detyrueshme për çdo anetar të fondit pensional gjate zgjedhjes së pare të një prej llojeve të pageses së pensionit edhe gjate ndryshimit të llojit të pageses së pensionit.

(2) Anetari i fondit pensional që ka llogari individuale në fondin pensional parashtron kerkese te shoqeria pensionale, e cila në emer të tij e fillon kuotizacionin në Qendren për Kuote. Në kerkese anetari i fondit pensional cakton se cilat menyra të pageses së pensionit deshiron të perfshihen në kuote.

(3) Në afat prej pese ditesh nga pranimi i kerkeses nga paragrafi (2) i ketij neni, shoqeria pensionale eshte e detyruar që të parashtroje kerkese për kuotizacion në Qendren për Kuote me numer identifikues të kuotizacionit dhe të dhenat në vijim: shumen e mjeteve në llogarine individuale, gjinine dhe datelindjen e anetarit të fondit pensional, dhe llojet e pageses së pensionit

(4) Anetari i fondit pensional që eshte percaktuar për kombinim të terheqjeve të programuara të perkohshme dhe anuitetit të prolonguar të perhershem, e definen edhe periudhen e prolongimit dhe raportin ndermjet ketyre dy llojeve të pensioneve. Anetari i fondit pensional mund të kerkoje disa lloje të ndryshme të anuiteteve të kuotohen nga ana e shoqerive të sigurimit.

Neni 30

Kuota për pensione nga ana e shoqerive të sigurimit dhe shoqerive pensionale

(1) Shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale jane të obliguara që në afat prej pese ditesh nga futja e kerkeses për kuotizacion në Qendren për Kuote, t'i prezantojne ofertat e tyre.

(2) Ofertat për anuitetet e perhershme dhe për terheqjet e programuara të perkohshme në kombinim me anuitetin e prolonguar të perhershem i prezantojne shoqerite e sigurimit, ndersa ofertat për terheqjet e programuara të perkohshme i prezantojne shoqerite pensionale. Shoqerite e sigurimit që japin oferta për terheqjet e programuara të perkohshme në kombinim me anuitetin e prolonguar të perhershem, japin oferta të vecanta për çdo shoqeri pensionale.

(3) Të gjitha ofertat e bera nga shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale e paraqesin pensionin fillestar të çdo lloji të ofruar të pageses së pensionit dhe pensionit të projektuar, i cili do të paguhet pas dhjete dhe pas 20 vitesh. Për terheqjet e programuara sigurohen edhe projeksione të shumave në llogarine individuale në fund të periudhes prej dhjete dhe 20 vitesh. Pensioni fillestar, dhe pensionet e projektuara dhe shumat në llogarine individuale për terheqjet e programuara pas dhjete dhe 20 vitesh, shprehen në denare me fuqi blerese konstante, të harmonizuara deri në fuqine e tanishme blerese të denarit.

(4) Pensionet e projektuara dhe shumat në llogarine individuale në fund të periudhes prej dhjete dhe 20 viteve llogariten me keto parakushte: formula për terheqjet e programuara në menyre perkatese zbatohet në çdo 12 muaj, fondi fiton shkalle reale të të ardhurave që shfrytëzohet në llogaritjen e pensionit të pare, kompensimet rrjedhese që i arketon çdo shoqeri pensionale do të arkëtohen edhe në të ardhmen dhe shfrytëzuesi i pensionit do ta perjetoje fundin e secilit vit projektues.

(5) MAPAS-i e percakton menyren e kryerjes së projeksioneve të pensioneve dhe shumave në llogarine individuale në fund të periudhes prej dhjete dhe 20 vitesh për terheqjet e programuara.

(6) ASS-ja e percakton menyren e kryerjes së projeksioneve të pensioneve permes anuiteteve për periudhen pas dhjete dhe 20 viteve, sipas rregullave dhe parakushteve që jane në perputhje me qasjen për projektim të pensioneve permes terheqjeve të programuara dhe shumave në llogari.

(7) Pas perfundimit të periudhes për kuote, Qendra për Kuote dorezon te shoqeria pensionale tabele permbledhese me të gjitha ofertat e marra për anetarin e fondit pensional.

(8) MAPAS-i më afersisht e rregullon menyren në të cilen ofertat i prezantohen anetarit të fondit pensional dhe menyren në të cilen pensionet e ardhshme të projektuara jane shprehur në fuqine blerese të tanishme të denarit, në kohen e kuotizacionit të pensionit.

Neni 31

Kuota vullnetare nga ana e shoqerive të sigurimit

(1) Shoqeria e sigurimit nese deshiron të prezantoje oferte, me kerkese të anetarit të fondit pensional mund të prezantoje oferte për një ose më shume lloje të pagesave të pensionit për të cilat anetari ka parashtruar kerkese. Ofertat kane vlefshmeri prej 30 diteve nga dita e prezantimit të ofertes. Pas kalimit të periudhes prej 30 diteve, shoqeria e sigurimit mund ta refuzoje lidhjen e polices për anuitet me anetarin.

(2) Shoqeria e sigurimit eshte e obliguar të prezantoje oferte permes Qendres për Kuote për lidhjen e polices për anuitet.

Neni 32

Marreveshje ndermjet anetarit të fondit pensional dhe shoqerive të sigurimit dhe shoqerive pensionale për llojin e pageses së pensionit

(1) Shoqeria pensionale, pas marrjes së tabelës permbledhese nga Qendra për Kuote, e njofton anetarin e fondit pensional se jane marre oferta nga shoqeria e sigurimit dhe/ose shoqeria pensionale. Me kerkese të anetarit shoqeria pensionale eshte e obliguar që të dorezoje tabele permbledhese me të gjitha ofertat e pranuar, të verifikuar dhe të nenshkruar nga ana e shoqerise. Tabela permbledhese e permban numrin identifikues të kuotes nga kerkesa nga neni 29 paragrafi (3) i ketij ligji.

(2) Anetari i fondit pensional në periudhe prej 30 diteve të vlefshmerise së ofertave, mund të zgjedhe oferte të theksuar në tabelen permbledhese nga paragrafi (1) i ketij neni.

(3) Nese anetari i fondit pensional ka zgjedhur të pranoje pension nga shtylla e dyte permes terheqjes së programuar, lidh marreveshje me shoqerine pensionale oferten e së ciles e ka pranuar.

(4) Nese anetari i fondit pensional ka zgjedhur të pranoje pension të shtylles së dyte permes anuitetit, nenshkruan police për anuitet me shoqerine e sigurimit oferten e së ciles e ka pranuar.

(5) Nese anetari i fondit pensional ka zgjedhur të pranoje pension të shtylles së dyte si kombinacion i terheqjeve të programuara dhe anuitetit të prolonguar të perhershem, lidh marreveshje me shoqerine pensionale dhe nenshkruan police për anuitet me shoqerine e sigurimit ofertat e së ciles i ka pranuar.

(6) Shoqeria e sigurimit dhe shoqeria pensionale nuk guxon të refuzojne lidhjen e marreveshjes ose polices për anuitet me anetarin i cili e ka zgjedhur oferten e saj.

(7) Anetari i fondit pensional dorezon kopje nga marreveshja me shoqerine pensionale dhe/ose polica për anuitet, te shoqeria pensionale e cila menaxhon me fondin pensional ku ai eshte anetar.

Neni 33

E drejta e perseritjes së procesit të kuotimit e anetarit të fondit pensional

(1) Anetari i fondit pensional nuk eshte i obliguar të zgjedhe oferte të marre permes Qendres për Kuote ose oferte të marre gjate negociatave me shoqerine e sigurimit.

(2) Nese anetari i fondit pensional nuk bën zgjedhje te shoqeria pensionale e cila menaxhon me atë fond, do të konsiderohet se nuk ka zgjedhur lloj të pageses së pensionit të shtylles së dyte, rast në të cilin zbatohet neni 35 i ketij ligji.

(3) Anetari i fondit pensional mund të kerkoje kuotizacion permes Qendres për Kuote në menyre të pakufizuar.

Neni 34

Realizimi i të drejtes së pensionit vetem nga shtylla e dyte

(1) Anetari i fondit pensional që nuk ka realizuar të drejte të pensionit sipas pleqerise në Fondin e SPIM-it për shkak të mosplotesimit të kushteve ligjore, kerkesen për realizimin e të drejtes së pensionit vetem nga shtylla e dyte e parashton te shoqeria pensionale e cila menaxhon me fondin pensional ku ai eshte anetar.

(2) Kerkesa për realizimin e të drejtes së pensionit vetem nga shtylla e dyte parashtrohet pas mbushjes së moshes 65 vjecare. Me kerkesa anetari dorezon edhe vertetim të leshuar nga Fondi i SPIM-it, se nuk e ka realizuar të drejten për pension për shkak të mosplotesimit të kushteve në lidhje me kohezgjatjen e stazhit pensional dhe deklarates së verifikuar te noteri se heq dore nga e drejta për pension nga shtylla e pare dhe e drejta e shumes më të ulet të pensionit. Anetari i fondit pensional mund të zgjedh ndermjet:

a) pageses së njehershme të mjeteve nga shtylla e dyte nga llogaria e tij individuale ose

b) realizimit të pensionit vetem nga mjetet e shtylles së dyte, nese pensioni eshte më i madh ose i barabarte me 40% të shumes më të ulet të pensionit në ditën e realizimit të së drejtes së pensionit nga shtylla e dyte.

Neni 35

Prolongimi i realizimit të pensionit nga shtylla e dyte

(1) Shfrytezuesi i pensionit të shtylles së pare mund ta prolongoje realizimin e pensionit të shtylles së dyte deri në tri vjet nga dita e fitimit të së drejtes së pensionit sipas pleqerise nga shtylla e pare. Pas kalimit të kesaj periudhe, duhet të zgjedhe një nga llojet e percaktuara të pageses së pensionit nga shtylla e dyte.

(2) Nese pas kalimit të tri viteve, shfrytezuesi i pensionit nga shtylla e pare nuk e zgjedh njerin nga llojet e percaktuara të pageses së pensionit, behet shfrytezues i pensionit të shtylles së dyte permes terheqjeve të programuara të perhershme nga fondi pensional ku ai ka llogari individuale dhe shoqeria pensionale fillon me pagesen e pensionit.

(3) Nese shfrytezuesi i pensionit të shtylles së dyte nuk e njofton shoqerine pensionale nga paragrafi (2) i ketij neni për llogarine e transaksionit për bartjen e mjeteve për pension, shoqeria pensionale terheqjet e programuara i paguan në llogarine e transaksionit në të cilën Fondi i SPIM-it bën pagese të pensionit të shtylles së pare. Fondi i SPIM-it dorezon të dhena për adresen dhe llogarine e transaksionit të shfrytezuesit të pensionit nga shtylla e dyte, me kerkesa të shoqerise pensionale.

(4) Nese Fondi i SPIM-it nuk e kryen pagesen e pensionit të shtylles së pare, shoqeria pensionale nuk bën pagese të terheqjeve të programuara dhe i ruan mjetet në llogarine individuale të shfrytezuesit të pensionit të shtylles së dyte.

(5) Shfrytezuesi i pensionit ka të drejte të zgjedhe një nga llojet e percaktuara të pageses së pensionit edhe pasi shoqeria pensionale të kete filluar me pagese në pajtim me paragrafin (2) të ketij neni ose i ruan mjetet në llogarine individuale të shfrytezuesit të pensionit nga shtylla e dyte në pajtim me paragrafin (4) të ketij neni.

Kreu 9

Bartja e mjeteve dhe evidenca që e mbajne shoqerite pensionale

Neni 36

Bartja e mjeteve nga shoqeria pensionale në shoqeri të sigurimit dhe/ose shoqeri pensionale

(1) Pas pranimit të polices për anuitet dhe/ose marreveshjes me shoqerine pensionale nga neni 32 i ketij ligji, shoqeria pensionale i bart mjetet nga llogaria individuale e anetarit të fondit pensional në llogarine e transaksionit të shoqerise së sigurimit dhe/ose në llogarine e fondit pensional të menaxhuar nga shoqeria pensionale e zgjedhur nga anetari. Për bartjen e kryer, shoqeria pensionale nuk guxon të arketoje kompensime nga anetari ose nga shoqeria e sigurimit, ose nga shoqeria e pensionale e zgjedhur nga anetari, pervec provizioneve të transaksionit.

(2) Shoqeria pensionale eshte e obliguar që ta kryeje bartjen e mjeteve në shoqerine e sigurimit ose në fondin pensional në afat prej një muaji nga dita e pranimit të polices për anuitet dhe/ose marreveshjes me shoqerine pensionale.

(3) Nese mjetet jane bartur në gjysmen e pare të një muaji kalendarik, shoqeria e sigurimit dhe/ose shoqeria pensionale eshte e obliguar që pagesen e pare të pensionit ta kryeje gjate gjysmes së dyte të atij muaji. Nese mjetet jane bartur në gjysmen e dyte të një muaji kalendarik, pagesa e pare e pensionit eshte në gjysmen e pare të muajit të ardhshem.

Neni 37

Evidenca të cilen e mbajne shoqerite pensionale

(1) Shoqeria pensionale që menaxhon me fondin pensional ku anetari ka pasur llogari individuale gjate realizimit të pensionit nga shtylla e dyte, eshte e obliguar që ta mbaje dhe ta ruaje evidencen e plote me të gjithë të dhenat në lidhje me procesin për zgjidhjen e llojit të pageses së pensionit nga shtylla e dyte. Evidenca ruhet për periudhe prej 50 viteve. Evidenca mbahet për çdo anetar të fondit pensional dhe i perfshin: llojin e zgjedhur të pageses së pensionit nga shtylla e dyte ose kombinimit të tyre; shumen e pergjithshme të mjeteve në llogarine individuale; titullin e shoqerise/shoqerive të zgjedhura për pagesen e pensioneve nga shtylla e dyte; lartesine e pensionit të realizuar nga shtylla e dyte; karakteristikat e anuitetit, siç jane periudha e garantuar, periudha e prolongimit, anuiteti fiks ose variabel, shfrytëzuesin/shfrytëzuesit e percaktuar për anuitet të garantuar; karakteristikat themelore të terheqjeve të programuara të perkohshme në kombinim me anuitetin e prolonguar të perhershem; shumen e pensionit që fitohet nga secili lloj i pageses së pensionit dhe raportin e tyre.

(2) Evidenca nga paragrafi (1) i ketij neni ruhet edhe në rast të pageses së njehershme të mjeteve nga llogaria individuale anetarit të fondit pensional.

Kreu 10

Shkembimi i të dhenave për zbatimin e shumës më të ulet të pensionit

Neni 38

Shkembimi i të dhenave për anetar të fondit pensional i cili ka realizuar lloj të pageses së pensionit nga shtylla e dyte

(1) Shoqerite pensionale dhe shoqerite e sigurimit jane të obliguara që ta njoftojne fondin e SPIM-it, një here në muaj, për çdo anetar të fondit pensional që ka realizuar lloj të pageses së pensionit nga shtylla e dyte në atë periudhe. Njoftimi permban të dhena për: llojin e pageses së zgjedhur të pensionit, titullin e shoqerise ose shoqerive të zgjedhura për pagesen e pensionit nga shtylla e dyte, lartesine e pensionit të shtylles së dyte dhe karakteristikat tjera lidhur me periudhen e garantuar, anuitetin e prolonguar ose anuitetin e drejtperdrejte, raportin ndermjet terheqjeve të programuara të perkohshme dhe anuitetit të prolonguar, anuitetin fiks me pjesemarrje në fitim.

(2) Në baze të të dhenave nga paragrafi (1) i ketij neni, Fondi i SPIM-it mban evidence për nevojen e dallimit deri në shumen më të ulet të pensionit për çdo shfrytezues të pensionit në vecanti.

(3) MAPAS-i e percakton menyren e mbajtjes së evidences dhe llojin e të dhenave që shoqerite pensionale dhe shoqerite e sigurimit i dorezojne te Fondi i SPIM-it.

Neni 39

Të dhenat që shoqeria pensionale i dorezon te shoqeria e sigurimit dhe shoqeria pensionale

(1) Shoqeria pensionale dorezon kopje të aktvendimit të marre nga Fondi i SPIM-it nga neni 28 paragrafi (2) i ketij ligji, te shoqeria e sigurimit ose shoqeria pensionale e zgjedhur nga shfrytezuesi i pensionit, në afat prej pese ditesh nga dita e marrjes së të dhenave.

(2) Pas marrjes së të dhenave nga paragrafi (1) i ketij neni, shoqeria e sigurimit ose shoqeria pensionale eshte e obliguar që çdo muaj të kryeje kontroll nese shuma e pensionit të shtylles së dyte dhe pensionit të percaktuar nga shtylla e pare eshte më e vogel se shuma më e ulet e pensionit e percaktuar me rregullat e sigurimit pensional dhe invalidor.

Kreu 11

Zbatimi i të drejtes së shumes më të ulet të pensionit

Neni 40

Obligimet e shoqerive të sigurimit dhe shoqerive pensionale për zbatimin e të drejtes së shumes më të ulet të pensionit

(1) Shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale jane të obliguara që të kontrollojne nese shfrytezuesi i pensionit të shtylles së dyte ka të drejte të dallimit deri në shumen më të ulet të pensionit, në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor.

(2) Kontrolli nga paragrafi (1) i ketij neni kryhet çdo muaj permes krahasimit të shumes së lartesisë mujore të pensionit që paguhet nga shtylla e dyte dhe lartesisë mujore të pensionit të realizuar nga shtylla e pare, me shumen më të ulet të pensionit. Nese ekziston dallim deri në shumen më të ulet të pensionit, shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale e njoftojne Fondin e SPIM-it për lartesine mujore të pensionit nga shtylla e dyte dhe lartesine e pensionit të realizuar nga shtylla e pare, për çdo shfrytezues të pensionit. Ky njoftim kryhet në afat prej tri diteve nga llogaritja e pensionit për shtyllen e dyte.

(3) Gjate kryerjes së llogaritjeve shfrytezohen të dhenat për lartesine e shumave më të uleta të pensionit dhe të dhenat për harmonizimin e pensioneve, të shpallura në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".

(4) MAPAS-i e percakton menyren në të cilen shoqerite pensionale bejne krahasim të shumave mujore të terheqjeve të programuara dhe të pensionit të realizuar nga shtylla e pare.

(5) ASS-ja e percakton menyren në të cilen shoqerite e sigurimit bejne krahasim të shumave mujore të pensionit me anuitet dhe të pensionit të realizuar nga shtylla e pare.

Neni 41

Obligimet e Fondit të SPIM-it lidhur me dallimin deri në shumen më të ulet të pensionit

(1) Fondi i SPIM-it pas të dhenave të fituara nga neni 40 paragrafi (2) i ketij ligji dhe me shfrytezimin e evidences personale për pagesen e pensioneve nga shtylla e pare, kryen kontroll të dallimit të llogaritur deri në shumen më të ulet të pensionit.

(2) Nese Fondi i SPIM-it konstaton mosperputhje në dallimin e llogaritur deri në shumen më të ulet të pensionit nga ana e shoqerive të sigurimit dhe shoqerive pensionale, i njofton keto shoqeri çdo muaj, për çdo shfrytezues për të cilin eshte kryer pagesa plotesuese e dallimit deri në shumen më të ulet të pensionit.

(3) Fondi i SPIM-it eshte i obliguar të kryeje pagese të dallimit deri në shumen më të ulet të pensionit

Kreu 12

Rregulla gjate pageses së dallimit deri në shumen më të ulet të pensionit

Neni 42

Pagesa e dallimit deri në shumen më të ulet të pensionit kur pensioni nga shtylla e dyte paguhet si terheqje e programuar

(1) Nese shuma e pensionit permes terheqjeve të programuara dhe pensionit nga shtylla e pare eshte më e vogel se shuma më e ulet e pensionit, shoqeria pensionale eshte e obliguar që ta zmadhoje pagesen permes terheqjeve të programuara me pagese plotesuese ashtu që shuma e pensionit permes terheqjeve të programuara dhe pensionit nga shtylla e pare të jete e barabarte me lartesine e shumes më të ulet të pensionit të percaktuar me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor. Pagesen e terheqjes së programuar me pagese plotesuese deri në lartesine e shumes më të ulet të pensionit, shoqeria pensionale e kryen deri sa të kete mjete në llogarine individuale të shfrytezuesit të pensionit nga shtylla e dyte.

(2) Nese mjetet në llogarine individuale të shfrytezuesit të pensionit harxhohen, shoqeria pensionale më tej nuk paguan pension permes terheqjeve të programuara dhe në afat prej tri diteve e njofton Fondin e SPIM-it. Shfrytezuesit të pensionit Fondi i SPIM-it eshte i obliguar që t'i paguaje pension nga shtylla e pare dhe dallim deri në shumen më të ulet të pensionit.

Neni 43

Pagesa e dallimit deri në shumen më të ulet të pensionit kur pensioni nga shtylla e dyte paguhet si anuitet pensional

(1) Nese shuma e pensionit permes anuiteteve pensionale dhe pensionit nga shtylla e pare eshte më e vogel se shuma më e ulet e pensionit, Fondi i SPIM-it eshte i obliguar që krahas pensionit nga shtylla e pare të paguaje edhe dallim deri në shumen më të ulet të pensionit në baze të të dhenave të marra nga shoqeria e sigurimit.

(2) MAPAS-i e percakton menyren e kontrollit dhe pageses plotesuese të shumes më të ulet të pensionit nga ana e shoqerive pensionale. ASS-ja me pelqim paraprak nga MAPAS-i e percakton menyren për kontrollin e shumes më të ulet të pensionit nga ana e shoqerive të sigurim.

Neni 44

Perjashtim nga zbatimi i të drejtes së shumes më të ulet të pensionit kur realizimi i pensionit nga shtylla e dyte eshte prolonguar

Nese shfrytezuesi i pensionit nga shtylla e pare e prolongon realizimin e pensionit nga shtylla e dyte, nuk do të paguhet shume më e ulet e pensionit deri atehere kur do të filloje të paguhet pensioni nga shtylla e dyte.

Kreu 13

Zgjedhja e llojit të pensionit nga shtylla e dyte nga personi i cili ka realizuar të drejte të pensionit invalidor ose familjar

Neni 45

Mbajtja e mjeteve nga shtylla e dyte

(1) Gjate parashtrimt të kerkeses për pension invalidor ose familjar te Fondi i SPIM-it, anetari i fondit pensional i cili kerkon të realizoje të drejte për pension invalidor ose personi i cili kerkon të realizoje pension familjar nga anetari i fondit pensional, e dorezon emrin e shoqerise pensionale që menaxhon me fondin pensional në të cilin eshte llogaria individuale e anetarit.

(2) Fondi i SPIM-it te shoqeria pensionale dorezon të dhena për shumen e pensionit që do të paguhet nga shtylla e pare, adresen e anetarit të fondit pensional që kerkon të realizoje të drejte për pension invalidor ose personit që kerkon të realizoje të drejten për pension familjar, me ç'rast

për pension familjar dorezon edhe të dhena për: datelindjen, gjinine dhe periudhen e shfrytezimit të pensionit për çdo shfrytezues. Periudha e shfrytezimit të pensionit mund të jete e perkohshme nese pensionin e shfrytezojne femijet gjate shkollimit ose e perhershme për anetaret tjere të familjes.

(3) Shoqeria pensionale e perllogarit pensionin familjar permes terheqjeve të programuara nga mjetet e llogarise individuale të anetarit të shtylles së dyte, sipas ketyre rregullave:

a) nese ka së paku një shfrytezues i cili pensionin familjar do ta shfrytezoje gjate gjithë jetes, llogaritet pension i perhershëm individual permes terheqjeve të programuara për shfrytezuesin më të ri që do ta shfrytezoje pensionin gjate gjithë jetes. Nese pensioni familjar i llogaritur në kete menyre eshte më i madh ose i barabarte me pensionin e caktuar nga Fondi i SPIM-it, atehere bartesi i të drejtes së pensionit familjar ka të drejte të zgjedhe nese:

1) mjetet nga llogaria individuale e anetarit, do t'i mbaje dhe do të heqe dore nga pensioni familjar nga shtylla e pare, me ç'rast shoqeria pensionale fillon me pagesen e terheqjeve të programuara ose

2) mjetet nga llogaria individuale e anetarit do të barten në Fondin e SPIM-it, me ç'rast Fondi i SPIM-it fillon me pagesen e pensionit familjar dhe

b) Nese nuk ka shfrytezues të cilet pensionin familjar do ta shfrytezojne gjate gjithë jetes, perllogaritet pension i perkohshëm individual permes terheqjeve të programuara për shfrytezuesin më të ri i cili do ta shfrytezoje pensionin perkohesisht. Nese pensioni familjar i perllogaritur në kete menyre eshte më i madh ose i barabarte me pensionin e caktuar nga Fondi i SPIM-it, atehere bartesi i të drejtes së pensionit familjar ka të drejte të zgjedhe nese:

1) mjetet nga llogaria individuale e anetarit, do t'i mbaje dhe do të heqe dore nga pensioni familjar nga shtylla e pare, me ç'rast shoqeria pensionale fillon me pagesen e terheqjeve të programuara ose

2) mjetet nga llogaria individuale e anetarit do të barten në Fondin e SPIM-it, me ç'rast Fondi i SPIM-it fillon me pagesen e pensionit familjar.

(4) Shoqeria pensionale e llogarit pensionin invalidor për anetarin si pension i perhershëm individual permes terheqjeve të programuara. Nese pensioni familjar i llogaritur në kete menyre eshte më i madh ose i barabarte me pensionin e caktuar nga Fondi i SPIM-it, atehere anetari në shtyllen e dyte ka të drejte te zgjedhe nese:

a) mjetet nga llogaria individuale, do t'i mbaje dhe do të heqe dore nga pensioni invalidor nga shtylla e pare, me ç'rast shoqeria pensionale fillon me pagesen e terheqjeve të programuara ose

b) mjetet nga llogaria individuale e anetarit do të barten në Fondin e SPIM-it, me ç'rast Fondi i SPIM-it fillon me pagesen e pensionit invalidor.

(5) Shoqeria pensionale e njofton anetarin e fondit pensional i cili kerkon ta realizoje të drejten e pensionit invalidor ose personin i cili kerkon të realizoje pension familjar nga anetari i fondit pensional, për llogaritjet e kryera nga paragrafet (3) dhe (4) të ketij neni.

(6) Nese nga llogaritjet nga paragrafet (3) dhe (4) të ketij neni, konstatohet se pensioni nga shtylla e dyte eshte më i vogel se shuma e pensionit nga shtylla e pare, mjetet e anetarit të fondit pensional barten në Fondin e SPIM-it, me ç'rast Fondi i SPIM-it fillon me pagesen e pensionit invalidor, respektivisht familjar.

(7) Nese nga llogaritjet nga paragrafet (3) dhe (4) të ketij neni, konstatohet se pensioni nga shtylla e dyte eshte më i madh se pensioni nga shtylla e pare, anetari i fondit pensional që kerkon ta realizoje të drejten e pensionit invalidor ose personi që kerkon të realizoje pension familjar, zgjedh një nga mundesite nga paragrafet (3) dhe (4) të ketij neni.

(8) Anetari i fondit pensional që kerkon të realizoje të drejte të pensionit invalidor ose personi që kerkon të realizoje pension familjar nga anetari i fondit pensional, zgjedhjen e kryen në shoqerine pensionale permes deklarates, ndersa shoqeria pensionale dorezon kopje të deklarates në Fondin e SPIM-it dhe në MAPAS.

Neni 46

Percaktimi i pageses së pensionit nga shtylla e dyte

(1) Nese personi i cili kerkon të realizoje pension familjar ka hequr dore nga pensioni i shtylles së pare dhe ka bere zgjedhje që të shfrytezoje pension të shtylles së dyte, shoqeria pensionale e llogarit pensionin e shtylles së dyte sipas ketyre rregullave:

a) nese ka së paku një shfrytezues i cili pensionin familjar do ta shfrytezoje gjate gjithë jetes, shoqeria pensionale llogarit pension të perhershëm individual permes terheqjeve të programuara në baze të të dhenave për shfrytezuesin më të ri dhe ia paguan në muaj bartesit të pensionit;

b) nese vdesin të gjithë shfrytezuesit e perhershëm ose nuk ka shfrytezues të perhershëm, shoqeria pensionale llogarit pension të perhershëm individual permes terheqjeve të programuara në baze të të dhenave për shfrytezuesin më të ri të perkohshëm dhe pensionin ia paguan në muaj bartesit të pensionit dhe

v) nese nuk ka shfrytezues të perhershëm dhe të perkohshëm, të gjitha mjetet e mbetura në llogarine individuale të anetarit trashegohen në pajtim me ligjin.

(2) Nese personi që kerkon të realizoje pension invalidor ka hequr dore nga pensioni i shtylles së pare dhe ka bere zgjedhje që të shfrytezoje pension të shtylles së dyte, shoqeria pensionale e llogarit pensionin invalidor për anetarin si pension të perhershëm individual permes terheqjeve të programuara. Nese shfrytezuesi i pensionit të shtylles së dyte vdes, të gjithë mjetet e mbetura në llogarine e tij individuale trashegohen në pajtim me ligjin.

(3) Shoqeria pensionale pagesen e pensionit ia kryen në llogari të transaksionit shfrytezuesit, respektivisht bartesit të pensionit.

Neni 47

**Formula për llogaritjen e pensionit invalidor
ose familjar nga shtylla e dyte**

Percaktimi i terheqjeve të programuara nga nenet 45 dhe 46 të ketij ligji, behet në pajtim me nenin 16 të ketij ligji.

Kreu 14

Pagesat e pensioneve nga shtylla e dyte

Neni 48

**Njesia monetare për pagesen e pensioneve nga shtylla
e dyte**

(1) Të gjitha pensionet nga shtylla e dyte paguhen në denare.

(2) Policat për anuitet nga shtylla e dyte mund të shprehen në euro por pensionet paguhen në denare, sipas kursit të mesëm të Bankes Popullore të Republikës së Maqedonisë.

(3) Te anuitetet fikse me pjesëmarrje në fitim, shuma e pensionit shprehet në "pjesëmarrje" ose "njesi" por paguhet me denare, varesisht nga zgjedhja e njesise monetare për konversionin e "pjesëmarrjes/njesise" të bere nga shfrytezuesi i pensionit në ditën e blerjes.

Neni 49

**Datat dhe menytrat e pageses së pensioneve nga shtylla
e dyte**

(1) Shoqeria pensionale eshte e obliguar që terheqjet e programuara t'i paguaje në muaj, jo më vonë se 25-ti i muajit për muajin paraprak, me bartje të mjeteve në llogarine e transaksionit të shfrytezuesit të pensionit.

(2) Shoqeria e sigurimit eshte e obliguar që anuitetet t'ia paguaje në muaj, jo më vonë se 25-ti i muajit për muajin paraprak, me transfer elektronik të mjeteve në llogarine e transaksionit shfrytezuesit të pensionit, në menyre dhe procedure të percaktuara nga ASS-ja.

Neni 50

Tatimimi i pensioneve nga shtylla e dyte

Pensionet nga shtylla e dyte që paguhen përmes terheqjeve të programuara dhe përmes anuiteteve, i nënshtrohen tatimimit me tatim personal mbi të ardhura në pajtim me Ligjin për tatim personal mbi të ardhura. Shoqëria pensionale ose shoqëria e sigurimit e cila i paguan pensionet ka për obligim që të kryejë llogaritje dhe pagese të tatimit personal mbi ardhura në emer dhe për llogari të shfrytëzuesit të pensionit.

Neni 51

Ndalim për ngarkim të pensioneve nga shtylla e dyte

(1) Pensionet nga shtylla e dyte përmes anuiteteve ose terheqjeve të programuara, nuk mund të jepen si peng, të blihen e as të jene objekt përmbartimi.

(2) Policat për anuitet nga shtylla e dyte nuk mund të blihen.

(3) Mjetet nga shtylla e dyte të dedikuara për pensione përmes terheqjeve të programuara, nuk mund të jepen si peng, të blihen, e as të jene objekt përmbartimi.

Pjesa III

Kompensime pensionale nga sigurimi pensional vullnetar me financim kapital

Kreu 15

Pagesa e kompensimit pensional

Neni 52

Llojet e pagesave të kompensimit pensional

(1) Shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë pensionale kompensimin pensional e paguajnë me shfrytëzimin e një prej këtyre llojeve të pagesave, sipas zgjedhjes së anëtarit të fondit pensional:

a) anuitete;

b) terheqje të programuara;

v) pagesa të njehershme;

g) pagesa të shumëhershme dhe

d) kombinimi i pikeve a), b), v), dhe g) të këtij paragrafi.

(2) Gjate zgjedhjes së anuitetit anëtar i fondit pensional duhet të zgjedhë anuitet që do të përmbaje nga një karakteristike nga secili lloj i anuitetit të theksuar në pikat në vijim:

a) anuitete individuale dhe të përbashkëta;

b) anuitete të përhershme dhe të përkohshme;

v) anuitete të drejtperdrejta dhe të prolonguara;

g) me periudhe të garantuar ose periudhe të paguarantuar dhe

d) anuitete fikse, anuitete të ndryshueshme ose anuitete fikse me pjesëmarrje në fitim.

3) Shfrytëzuesi i pensionit, në rast të kompensimit pensional të kombinuar, vendos për sa lloje të kompensimeve pensionale do të ndahen mjete nga llogaria e tij individuale dhe e percakton pjesën për secilin lloj.

Neni 53

Ndryshimi i llojit të pageses së kompensimit pensional

(1) Polica për anuitet është marreveshje e pashkeputshme dhe nuk mund të ndërpritet as në rast të pelqimit edhe nga shfrytëzuesi i pensionit dhe nga shoqëria e sigurimit.

(2) Shfrytëzuesi i pensionit mundet në çdo moment ta zevendesojë terheqjen e programuar të siguruar nga një shoqëri pensionale me shfrytëzimin e mjeteve të mbetura të disponueshme nga llogaria vullnetare individuale dhe/ose profesionale për blerjen e terheqjeve të programuara nga shoqëria pensionale tjetër, blerjen e anuitetit nga shoqëria e sigurimit ose me pagese të njehershme ose të shumëhershme nga shoqëria pensionale

(3) Shfrytezuesi i pensionit mund ta zevendesojë pagesën e njehershme me shfrytezimin e mjeteve të mbetura të disponueshme nga llogaria vullnetare individuale dhe/ose profesionale për blerjen e anuitetit nga shoqëria e sigurimit, për blerjen e terheqjeve të programuara nga shoqëritë pensionale, me pagesë të shumehershme nga shoqëri tjetër pensionale ose me pagesë të njehershme.

(4) Mjetet që mbeten në llogarinë vullnetare individuale dhe/ose profesionale të shfrytezuesit të pensionit pas vdekjes së tij, janë pjesë e masës së trashëgimisë dhe me ato mjete veprohet në pajtim me Ligjin për trashëgimi.

(5) MAPAS-i e percakton menyren e zevendesimit të terheqjeve të programuara nga një shoqëri pensionale me terheqje të programuara nga shoqëria tjetër pensionale, me anuitet ose me pagesë të njehershme ose të shumehershme nga ana e shoqërisë pensionale.

(6) MAPAS-i e percakton menyren e zevendesimit të pagesës së shumehershme nga ana e shoqërisë pensionale me terheqje të programuara nga shoqëria tjetër pensionale, me anuitet ose me pagesë të njehershme ose të shumehershme nga ana e shoqërisë tjetër pensionale.

Kreu 16 **Rregulla për anuitete**

Neni 54

Llojet e anuiteteve

(1) Nese anuiteti është i garantuar, anetari i fondit pensional në policën për anuitet cakton shfrytezuesi i cili në rast të vdekjes së tij e shfrytëzon anuitetin deri në fund të periudhës së garantuar. Periudha e garantuar për anuitet është me kohezgjatje prej së paku 240 muajve.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, shfrytezuesi i pensionit në policën për anuitet mund të caktojë më shumë shfrytezues dhe radhë për shfrytëzim në rast të vdekjes së tij, të cilët e shfrytëzojnë anuitetin deri në fund të periudhës së garantuar.

(3) Nese anuiteti është i perbashkët anetari i fondit pensional në policën për anuitet cakton një ose më shumë shfrytezues të cilët në rast të vdekjes së tij e shfrytëzojnë anuitetin. Çdo shfrytezues fiton pjesë nga kompensimi pensional në lartësi të definuar nga ana e anetarit të fondit pensional në police, ndërsa shuma e të gjithë pjesëve të cilat i marrin shfrytezuesit nuk mund të tejkalojë 100% të lartësisë së kompensimit pensional.

(4) Nese anuiteti është i garantuar bashkërisht, pas vdekjes së anetarit të fondit pensional, shfrytezuesit e caktuar deri në fund të periudhës së garantuar e pranojnë kompensimin pensional në lartësi prej 100% që i ndahet çdo shfrytezuesi, në pajtim me lartësitë e pjesëve të kompensimit pensional të definuara nga ana e anetarit të fondit pensional në police. Pas perfundimit të periudhës së garantuar, secili shfrytezues e merr pjesën e kompensimit pensional të definuar nga anetari i fondit pensional në police.

(5) Nese anuiteti është i garantuar i prolonguar, periudha e garantuar fillon me perfundimin e periudhës së prolongimit.

Neni 55

Subjekte përmes të cilave mund të shiten anuitete

(1) Policat për anuitete për shtyllën e tretë i shesin shoqëritë e sigurimit. Shoqëritë e sigurimit policat për anuitete i shesin përmes përfaqësuesit në sigurim, shoqërisë për përfaqësim në sigurim dhe shoqërisë brokëre të sigurimit, e cila është themeluar dhe punon në pajtim me Ligjin për supervizion të sigurimit.

(2) Shoqëria e sigurimit, përfaqësuesi në sigurim, shoqëria për përfaqësim në sigurim dhe shoqëria brokëre e sigurimit, gjatë shitjes së anuiteteve nuk guxojnë të ofrojnë lirime, kthim të mjeteve në para ose privilegje tjera anetarit të fondit pensional.

Neni 56

Caktimi i lartesisë së anuiteteve dhe arketimi i shpenzimeve

Shoqerite e sigurimit e caktojnë shumën e anuiteteve, vendosin për tabelat e vdekshmerisë, për parakushtet për shkallë të kamates, për shpenzimet për menaxhim dhe parakushtet tjera që shfrytëzohen gjatë caktimit të lartesisë së pensionit të ofruar.

Neni 57

Kompensime gjatë pagesës së anuiteteve

Shoqeria e sigurimit nuk guxon të paguajë kompensime gjatë pagesës së anuiteteve të shtylles së trete, përveç për shpenzimesh transaksioni.

Neni 58

Percaktimi i shumës së kompensimit pensional përmes anuitetit variabel dhe anuitetit fiks me pjesëmarrje në fitim

(1) Gjatë percaktimit të shumës së kompensimit pensional të paguar përmes anuitetit variabel dhe fiks me pjesëmarrje në fitim, shfrytëzohen simulime dhe projeksione me parametra dhe parakushte të lejuara.

(2) ASS-ja me pelqim paraprak të MAPAS-it, i percakton parametrat e lejuara që shoqerite e sigurimit dhe personat tjerë të autorizuar mund t'i shfrytëzojnë në materialet për marketing, simulime dhe projeksione për shumën e pensionit që në të ardhmen do të paguhet përmes anuitetit variabel dhe anuitetit fiks me pjesëmarrje në fitim.

(3) ASS-jka me pelqim paraprak të MAPAS-it, i percakton parakushtet që duhet të shfrytëzohen dhe të theksohen nga shoqerite e sigurimit dhe personat tjerë të autorizuar, vecanerisht parakushtet lidhur me të hyrat e mjeteve të investuara të shfrytëzuara në disa "skenare" dhe atë: "bazike", "optimiste" dhe "pesimiste". Të ardhura për "skenare bazike" percaktohen në baze të performansave të portofolit të mjeteve me perberje të njejtë të portofolit që ofrohet në pajtim me policen për anuitetin variabel dhe anuitetin fiks me pjesëmarrje në fitim, të realizuara së paku gjatë dhjetë viteve të fundit. Në simulime dhe projeksione duhet të theksohen jo vetëm të ardhurat mesatare, por edhe variabiliteti i të ardhurave dhe pasojat nga variabiliteti i atille në shumën e pensionit.

(4) Gjatë llogaritjes së anuitetit variabel dhe anuitetit fiks me pjesëmarrje në fitim në simulime dhe projeksione pensionale perfshihen kompensime, provizione dhe shpenzime dhe shenohen në police. Shuma e kompensimit pensional që i ofrohet shfrytëzuesit potencial të pensionit, paraqitet në shumën neto të zvogeluar paraprakisht për kompensime, provizione ose shpenzime.

Neni 59

Procedura në rast të falimentimit ose likuidimit të shoqerisë për sigurim

(1) Dispozitat e Ligjit për mbikeqyrje të sigurimit që kanë të bëjnë me falimentimin ose likuidimin e shoqerisë për sigurim, në mënyrë perkatese zbatohen edhe në rast të falimentimit ose likuidimit të shoqerisë për sigurim, që siguron kompensim pensional të shtylles së trete.

(2) Kërkesat e shfrytëzuesve të kompensimit pensional të shtylles së trete dhe personave të caktuar prej tyre, kanë të drejtë perparësie të permbushjes në raport me kreditorët tjerë të shoqerisë për sigurim.

Kreu 17

Rregulla lidhur me terheqje të programuara

Neni 60

Lloje të terheqjeve të programuara

(1) Shoqerite pensionale i ofrojnë llojet e terheqjeve të programuara, si vijojnë:

a) terheqje të programuara të perhershme dhe

b) terheqje të programuara të perkohshme.

(2) Shoqerite pensionale i shfrytezojne formulat nga neni 16 i ketij ligji, për llogaritje fillestare dhe për llogaritje vjetore të lartesisë së kompensimit pensional nga terheqja e programuar.

(3) Shoqeria pensionale paguan kompensim pensional permes terheqjes së programuar në baze mujore, me bartje të mjeteve në llogari transaksioni të percaktuar nga shfrytezuesi i kompensimit pensional.

Neni 61

Kompensime që paguhen për terheqje të programuara

(1) Shoqerite pensionale paguajne kompensime të mjeteve për terheqje të programuara nga shtylla e trete, në pajtim me nenin 117 paragrafi (1) pika b) të Ligjit për sigurim vullnetar pensional me financim kapital.

(2) Shoqerite pensionale arketojne shpenzime transaksioni për pagese të kompensimeve pensionale permes terheqjeve të programuara.

Neni 62

Investimi i mjeteve që ruhen për terheqje të programuara

Shoqerite pensionale i investojne mjetet që i menaxhojne për llojet e terheqjeve të programuara nga shtylla e trete, në pajtim me Ligjin për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital .

Kreu 18

Dispozita të perbashketa për anuitete dhe terheqje të programuara

Neni 63

Tabelat e vdekshmerise dhe shkallet e kamates për kompensime pensionale

(1) Standardet minimale dhe rregullat për percaktimin e tabelave të vdekshmerise, i percaktojne ASS-ja dhe MAPAS-i me kushte të njejta për shoqerite për sigurim dhe shoqerite pensionale, duke i pasur parasysh:

a) specifiken e popullates së perbere nga pensioniste që marrin pension permes anuitetit dhe shfrytezuesve të tyre dhe

b) permiresimin e jetegjatesise.

(2) ASS-ja i percakton rregullat dhe standardet minimale për llogaritje të rezervave teknike, ndersa shoqeria për sigurim detyrohet që për llogaritje të rezervave për anuitete të shfrytezoje tabela të vdekshmerise, në pajtim me standardet minimale të percaktuara nga ASS-ja.

(3) MAPAS-i i percakton rregullat dhe standardet minimale për tabelat e vdekshmerise, ndersa shoqeri pensionale detyrohet që për llogaritje të faktorit të anuitetit për kompensime pensionale nga shtylla e trete, permes terheqjeve të programuara të perhershme dhe të perkohshme, të shfrytezoje tabela të vdekshmerise në pajtim me standardet minimale të percaktuara nga MAPAS-i.

(4) Shoqerite për sigurim dhe shoqerite pensionale mbajne evidence dhe të dhena statistikore për vdekje faktike të shfrytezuesve të pensionit dhe detyrohen që të dhenat statistikore, t'i dorezojne në ASS dhe MAPAS në periudhe dhe forme të percaktuar nga ASS-ja dhe MAPAS-i.

(5) Standardet minimale dhe rregullat për percaktimin e shkalleve të kamates i percaktojne ASS-ja dhe MAPAS-i me kushte të njejta për shoqerite e sigurimit dhe shoqerite pensionale, duke i pasur parasysh:

a) shkallen e kamates që shfrytezohet për llogaritje të rezervave perkatesisht faktorit të anuitetit, që nuk mund të jete më e madhe nga shkalla mbizoteruese reale e tregut të të ardhurave të letrave debitore afatgjate me vlere dhe

b) shkallet reale afatgjata dhe afatmesme të të ardhurave bazohen në shkallet mbizoteruese nominale të tregut të të ardhurave për instrumente afatgjate dhe afatmesme debitorë, të zvogeluara për vleresimin e shkalles së shpenzimeve të jeteses për të njëjtat periudha dhe të vleresimit të shkalleve mbizoteruese të ardhshme të tregut për letra afatgjate dhe afatshkurtra me vlere pa rrezik, të pranishme në portofolin e fondeve pensionale dhe shoqerive të sigurimit.

(6) ASS-ja i percakton rregullat dhe standardet minimale për percaktimin e shkalleve të kamates, ndersa shoqeria për sigurim detyrohet që për llogaritje të rezervave për anuitete, të shfrytëzojë shkalle të kamates në pajtim me rregullat dhe standardet minimale të percaktuara nga ASS-ja.

(7) MAPAS-i i percakton rregullat dhe standardet minimale për percaktimin e shkalleve të kamates, ndersa shoqeria pensionale detyrohet që për llogaritje të faktorit të anuitetit për kompensime pensionale nga shtylla e trete përmes terheqjeve të programuara të perkohshme dhe të perhershme, të shfrytëzojë shkalle të kamatave në pajtim me rregullat dhe standardet minimale të percaktuara nga MAPAS-i.

Kreu 19

Rregulla që kane të bëjnë me pagesa të njëhershme dhe të shumëhershme

Neni 64

Shoqeri që sigurojnë pagese të njëhershme dhe të shumëhershme

Pagesa të e njëhershme dhe të shumëhershme të kompensimit pensional mund të kryejnë vetëm shoqerite për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, ose shoqerite për menaxhim me fondet vullnetare pensionale.

Neni 65

Investimi i mjeteve që ruhen për pagesa të njëhershme ose të shumëhershme

Shoqerite pensionale i investojnë mjetet që i menaxhojnë për pagese të njëhershme ose të shumëhershme, në pajtim me Ligjin për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital.

Neni 66

Kompensime që arketohen nga pagesa të njëhershme dhe të shumëhershme

Shoqerite pensionale arketojnë kompensime nga mjetet për pagese të njëhershme dhe të shumëhershme, në pajtim me nenin 117 paragrafi (1) pika b) të Ligjit për sigurimit pensional vullnetar me financim kapital.

Kreu 20

Marrja e të drejtes së kompensimit pensional

Neni 67

Procedura për marrjen e të drejtes së kompensimit pensional

(1) Anetari i fondit pensional dorezon kerkese për marrjen e të drejtes së kompensimit pensional te shoqeria pensionale që menaxhon me fondin pensional ku ai ka llogari vullnetare individuale ose profesionale, nese i ploteson kushtet për pagese të kompensimit pensional në pajtim me ligjin. Nese anetari i fondit pensional ka llogari individuale vullnetare dhe profesionale, mund të kerkojë bashkimin e mjeteve nga të dy llogarite. Nese llogarite janë në dy shoqeri pensionale, kerkesa dorezohet në njeren nga shoqerite pensionale.

(2) Kerkesa nga paragrafi (1) i ketij neni mund të parashtrohet më së voni deri në mbarimin e 70 vjeteve moshe të anetarit të fondit pensional.

(3) Nese plotesohen kushtet për të drejte të kompensimit pensional, shoqeria pensionale jep vertetim për lartesine e mjeteve të llogarise së tij individuale vullnetare dhe/ose profesionale dhe percakton numer identifikues të kuotes.

(4) Anetari i fondit pensional mund të vendos të kerkoje kuote në Qendren për Kuote për zgjedhje të llojit të kompensimit pensional, personalisht ose permes shoqerise pensionale dhe të kerkoje nga shoqeria pensionale numer identifikimi të kuotes.

(5) Nese anetari vendose që personalisht të kerkoje kuote në Qendren për Kuote për zgjedhje të llojit të kompensimit pensional, e shfrytazon vertetimin nga paragrafi (3) i ketij neni.

(6) Nese anetari i fondit pensional vendose të kerkoje kuote permes shoqerise pensionale, me shkrim e autorizon shoqerine për kerkese të kuotes në të cilen i thekson llojet e kompensimit pensional dhe e percakton pjesen e mjeteve të llogarise individuale vullnetare dhe/ose profesionale për secilin lloj.

(7) Në afat prej pese ditesh nga pranimi i kerkeses nga paragrafi (6) i ketij neni, shoqeria pensionale detyrohet të parashtroje kerkese për kuote në Qendren për Kuote me numer identifikues të kuotes dhe të dhenat si vijojne: shumata e mjeteve të llogarise individuale, gjinia dhe datelindja e anetarit, lloji i kompensimit pensional ose kombinimi i tyre, të percaktuara nga anetari i fondit pensional.

(8) Nese anetari i fondit pensional vendos të mos kerkoje kuote në Qendren për Kuote, parashtrohet kerkese te fondi pensional për pagese të mjeteve permes terheqjes së programuar, të njehershme ose të shumëhershme.

Neni 68

Kuota vullnetare për anuitet

(1) Shoqerite për sigurim nuk kane detyrim që të prezantojne oferta për shfrytezues të kompensimit pensional, por nese kuotojne në Qendren për Kuote ofertat e tyre kane vlefshmeri për 30 ditesh nga dita e kuotizacionit.

(2) Shoqerite për sigurim mund t'u prezantojne oferta të një ose më shume llojesh kompensimi pensional të kerkuara nga anetari i fondit pensional, personalisht anetarit ose shoqeria pensionale të autorizuar prej tij.

Neni 69

Kuote e detyrueshme për terheqje të programuar

Shoqerite pensionale jane të detyrueshme të prezantojne oferta në Qendren për Kuote, për terheqje të programuara të perhershme dhe të perkohshme për shfrytezues të kompensimit pensional dhe ofertat e tyre kane vlefshmeri prej 30 ditesh nga dita e kuotimit.

Neni 70

Kuote për anuitete dhe terheqje të programuara

Shoqerite për sigurim dhe shoqerite pensionale në afat prej pese ditesh nga dita e kerkeses, duhet t'ia prezantojne ofertat e veta permes Qendres për Kuote ose shoqerise pensionale ose personalisht anetarit të fondit pensional.

Neni 71

Marreveshje të kompensimeve pensionale

(1) Pas mbarimit të periudhes për kuotizacion, shoqeria pensionale nga Qendra për Kuote merr tablele permbledhese me të gjitha ofertat e marra për anetarin e fondit pensional.

(2) Shoqeria pensionale eshte e detyrueshme që t'ia prezantoje tabelen permbledhese anetarit të fondit pensional dhe i dorezon kopje të tableles permbledhese, të verifikuar dhe nenshkruar nga shoqeri pensionale.

(3) Nese anetari i fondit pensional zgjedh që të pranoje kompensim pensional si terheqje të programuar ose si pagese të njehershme ose të shumehershme, lidh marreveshje me shoqerine pensionale oferten e së ciles e ka pranuar.

(4) Nese anetari i fondit pensional ka zgjedhur të marre kompensim pensional si anuitet, nenshkruan police për anuitet me shoqerine për sigurim oferten e së ciles e ka pranuar.

(5) Nese anetari i fondit pensional ka zgjedhur të marre kompensim pensional si kombinim i terheqjes së programuar dhe anuitetit, lidh marreveshje me shoqerine pensionale dhe nenshkruan police për anuitet me shoqerine për sigurim ofertat e së ciles i ka pranuar.

(6) Shoqeria për sigurim dhe shoqeria pensionale nuk guxojne të refuzojne që të lidhin marreveshje ose police për anuitet me anetarin që e ka pranuar oferten e tyre.

(7) Anetari i fondit pensional dorezon kopje të marreveshjes dhe/ose polices për anuitet te shoqeria pensionale që menaxhon me fondin pensional ku ai eshte anetar.

(8) Nese anetari i fondit pensional ka zgjedhur të marre kompensim pensional si pagese të njehershme ose të shumehershme nga shoqeria pensionale, lidh marreveshje me shoqerine pensionale oferten e së ciles e ka pranuar. Pas kryerjes së pageses shoqeria pensionale leshon vertetim se të gjitha mjetet nga llogaria individuale vullnetare dhe/ose profesionale jane paguar. Shoqeria pensionale dorezon kopje të vertetimit në MAPAS.

Neni 72

E drejta e perseritjes së procesit të kuotimit

Anetari fondit pensional nuk eshte i detyruar të zgjedhe oferte të marre permes Qendres për Kuote dhe mund të kerkoje kuotim permes Qendres për Kuote në numer të pakufizuar.

Neni 73

Marrja e detyrueshme e së drejtes së kompensimit pensional

(1) Anetari i fondit pensional detyrimisht e realizon të drejten e kompensimit pensional kur i mbush 70 vite të jetes.

(2) Shoqeria pensionale eshte e detyrueshme që t'i drejtohet anetarit të fondit pensional që i ka mbushur 70 vite të jetes, për realizimin e së drejtes nga paragrafi (1) i ketij neni.

(3) Nese anetari i fondit pensional zgjedh një lloj kompensimi pensional, do të zbatohet procedura nga neni 71 i ketij ligji.

(4) Nese anetari i fondit pensional nuk kryen zgjedhje të llojit të kompensimit pensional, konsiderohet se ka zgjedhur pagese të njehershme nga shoqeria pensionale që menaxhon me fondin pensional ku anetari ka llogari individuale vullnetare dhe/ose profesionale dhe pagesa kryhet në llogarine e tij të transaksionit.

(5) Nese anetari i fondit pensional nuk e njofton shoqerine pensionale për llogarine e transaksionit ku duhen të barten mjetet e tij në menyre të njehershme, shoqeria pensionale i ruan mjetet në llogarine individuale vullnetare dhe/ose profesionale të anetarit.

Neni 74

Bartja e mjeteve

(1) Pas marrjes së polices për anuitet dhe/ose marreveshjes me shoqerine pensionale nga neni 71 i ketij ligji, shoqeria pensionale i bart mjetet nga llogaria individuale vullnetare dhe/ose profesionale e anetarit të fondit pensional në llogari transaksioni të shoqerise për sigurim dhe/ose në llogarine e fondit pensional të menaxhuar nga shoqeria pensionale e zgjedhur nga anetari. Për bartjen e kryer shoqeria pensionale nuk guxon të paguaje kompensime nga anetari ose nga shoqeria për sigurim, ose shoqeria pensionale e zgjedhur nga anetari, pervec provizioneve të transaksionit.

(2) Shoqeria pensionale detyrohet që të kryeje bartje të mjeteve në shoqerine për sigurim ose fondin pensional, në afat prej një muaji nga dita e marrjes së polices për anuitet dhe/ose marreveshjes me shoqerine pensionale.

(3) Nese mjetet barten në gjysmen e pare të një muaji kalendarik, shoqeria për sigurim detyrohet ta kryeje pagesen e pare të anuitetit, ndersa shoqeria pensionale detyrohet ta kryeje pagesen e pare të terheqjes së programuar gjate gjysmes së dyte të atij muaji. Nese mjetet jane bartur në gjysmen e dyte të një muaji kalendarik, shoqerite detyrohen që pagesen e pare të anuitetit perkatesisht terheqjen e programuar ta kryejne në gjysmen e pare të muajit të ardhshem.

Neni 75

Ndryshim i lartesisë së kompensimit pensional për shkak të ndryshimit të shumes së llogarise individuale vullnetare dhe/ose profesionale

Nese shuma e mjeteve të llogarise individuale vullnetare dhe/ose profesionale që shoqeria pensionale ia ka bartur shoqerise për sigurim, dallohet nga shuma në baze të ciles jane dhene ofertat, shoqeria për sigurim e zgjedhur nga anetari i fondit pensional detyrohet që proporcionalisht ta pershtate anuitetin që do të paguhet. Nese shuma e marre eshte më e larte nga shuma e shfrytezuar në kuota, anuiteti proporcionalisht rritet, e nese shuma e marre eshte më e vogel nga shuma e shfrytezuar në kuota, anuiteti proporcionalisht zvogelohet.

Neni 76

Evidenca që e mbajne shoqerite pensionale për realizim të kompensimit pensional

(1) Shoqeria pensionale që ka menaxhuar me fondin pensional ku anetari ka llogari individuale vullnetare dhe/ose profesionale, gjate realizimit të kompensimit pensional, detyrohet që ta mbaje dhe ruaje tere evidencen me të gjitha të dhenat lidhur me procesin për zgjedhje të kompensimit pensional. Evidenca mbahet për secilin anetar të fondit pensional dhe i perfshin: llojin e zgjedhur të kompensimit pensional ose kombinimin e tyre; shumen e pergjithshme të mjeteve të llogarise individuale vullnetare dhe/ose profesionale; emrin e shoqerise ose shoqerive të zgjedhura për pagese të kompensimit pensional; lartesine e kompensimit pensional të realizuar; karakteristikat e anuitetit siç jane periudha e garantuar; periudha e shtyrjes, anuiteti variabel ose fiks, shfrytezuesin ose shfrytezuesit e caktuar për anuitetin e garantuar dhe lloje tjera të anuitetit; karakteristikat themelore të terheqjeve të programuara të perkohshme në kombinim me anuitetin e shtyre; shumen e pensionit që merret nga çdo lloj i pageses së pensionit dhe perpjesetimin e tyre.

(2) Evidenca nga paragrafi (1) i ketij neni ruhet edhe në rast të pageses së njehershme ose të shumehershme të mjeteve nga llogaria individuale vullnetare dhe/ose profesionale e anetarit të fondit pensional.

Kreu 21

Pagesa e kompensimeve pensionale

Neni 77

Njesi monetare për pagese të kompensimeve pensionale

(1) Të gjitha kompensimet pensionale paguhen në denare.

(2) Policat për anuitet nga shtylla e trete mund të jene në euro, por kompensimet pensionale paguhen në denare, sipas kursit të mesem të Bankes Popullore të Republikes së Maqedonise.

(3) Te anuiteti variabel, shuma e pensionit shprehet në "pjese" ose "njesi", por paguhet në denare, varesisht nga zgjedhja e njesise monetare për konversion të "pjeses/njesise" të kryer nga ana e shfrytezuesit të pensionit në ditën e blerjes.

Neni 78

Data dhe menyra të pageses së kompensimit pensional

(1) Shoqeria pensionale detyrohet që terheqjet e programuara t'i paguaje në muaj, jo më vone se i 25-ti i muajit për muajin paraprak, me bartje të mjeteve në llogari transaksioni të shfrytezuesit të pensionit.

(2) Shoqeria për sigurim detyrohet që anuitetet t'i paguaje në muaj, jo më vonë se i 25-ti i muajit për muajin e paraprak, me bartje elektronike të mjeteve në llogari transaksioni të shfrytëzuesit të pensionit, në menyre dhe procedure të percaktuar nga ASS-ja.

(3) Pagesat e njehershme ose shumehershme mund të kryhen në cilendo ditë të muajit në llogari transaksioni të shfrytëzuesit të pensionit.

Neni 79

Tatimimi i kompensimeve pensionale

Kompensimet pensionale që paguhen përmes terheqjes së programuar dhe përmes anuiteteve, u nenshtrohen tatimit me tatimin personal mbi fitim, në pajtim me Ligjin për tatimin personal mbi fitim. Shoqeria pensionale ose shoqeria për sigurim që i paguan kompensimet pensionale, e ka për detyrë ta kryejë llogaritjen dhe pagesën e tatimit personal mbi fitim në emer dhe për llogari të shfrytëzuesit të pensionit.

Pjesa IV

Kreu 22

Dispozita ndëshkuese dhe për kundervajtje

Neni 80

Vepra penale

Personi përgjegjës në shoqeri pensionale, shoqeri për sigurim ose Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonise, i cili përmes paraqitjes së rrejshme ose fshehjes së fakteve, me mashtrim ose në menyre tjetër të paligjshme, ndikon në vendimmarrje për pensionim ose zgjedhje të llojit të pagesës së pensionit ose kompensimit pensional dhe me keto aktivitete i shkakton dëm financiar anëtarit të fondit pensional, do të dënohet me burg prej një deri më tre vite.

Neni 81

Barazimi dhe Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje

(1) Për kundervajtje të percaktuara në nenet 82, 83, 84 dhe 88 të këtij ligji, procedure për kundervajtje udheheq dhe sanksion për kundervajtje kumton Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje i ASS.

(2) Për kundervajtje të percaktuara në nenet 85, 86, 87 të këtij ligji, procedura për kundervajtje udheheq dhe sanksion për kundervajtje kumton Komisioni për Vendimmarrje për Kundervajtje i MAPAS-it.

(3) Dispozitat e Ligjit për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital që kanë të bëjnë me barazimin dhe Komisionin për Vendimmarrje për Kundervajtje, do të zbatohen në procedura lidhur me kundervajtjet e percaktuara me këto ligj.

(4) Dispozitat e Ligjit për sigurimin e supervizionit që kanë të bëjnë me ndermjetesimin dhe Komisionin për Vendimmarrje për Kundervajtje të ASS do të zbatohen në procedura lidhur me kundervajtjet e percaktuara me këto ligj.

Neni 82

(1) Gjore në shume prej 2 000 deri në 4 000 euro në kundërvlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje shoqerise për sigurim, nese:

1) gjate percaktimit të shumes të anuitetit të shtyre vepron në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (2) të këtij ligji;

2) nuk e harmonizon shumen e anuitetit që do të paguhet në pajtim me nenin 12 paragrafi (1) të këtij ligji;

3) nuk dorezon të dhena statistikore në ASS në periudhe dhe forme të percaktuar nga ASS-ja në pajtim me nenin 22 paragrafi (4) të ketij ligji dhe

4) nuk dorezon të dhena statistikore në ASS në periudhe dhe forme të percaktuar nga ASS-ja në pajtim me nenin 63 paragrafi (4) të ketij ligji.

(2) Gjore në shume prej 500 deri në 700 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në shoqerine për sigurim për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 83

(1) Gjore në shume prej 10 000 deri në 20 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje shoqerise për sigurim, nese:

1) e nderprene policen për anuitet në kundershtim me nenin 4 paragrafi (1) të ketij ligji;

2) kryen harmonizim të anuitetit fiks të harmonizuar me shpenzime të jeteses në kundershtim me nenin 6 paragrafi (1) të ketij ligji;

3) ofron zbritje, kthim të mjeteve në para ose privilegje tjera në kundershtim me nenin 7 paragrafi (2) të ketij ligji;

4) paguan kompensime në kundershtim të nenit 10 të ketij ligji;

5) e llogarit lartesine e pensionit për shtyllë të dyte permes anuitetit fiks me pjesemarrje në fitim, në kundershtim me nenin 11 paragrafet (1) dhe (4) të ketij ligji;

6) nuk prezanton oferte në afatin e percaktuar në nenin 30 paragrafi (1) të ketij ligji;

7) nuk e kryen pagesen e pare të anuitetit në afatin e percaktuar në nenin 36 paragrafi (3) të ketij ligji;

8) nuk e njofton fondin e SIPM-it në pajtim me nenin 38 paragrafi (1) të ketij ligji;

9) nuk e kontrollon lartesine e shtylles së dyte në pajtim me nenin 39 paragrafi (2) të ketij ligji;

10) nuk kryen kontrolle në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) të ketij ligji;

11) kryen pagese të anuiteteve në kundershtim me nenin 49 paragrafi (2) të ketij ligji;

12) nuk e kryen zvogelimin e tatimit gjate pageses së pensioneve nga shtylla e dyte dhe kompensimeve pensionale nga shtylla e trete, në pajtim me nenet 50 dhe 79 të ketij ligji;

13) e nderprene policen për anuitet në kundershtim me nenin 53 paragrafi (1) të ketij ligji;

14) ofron zbritje, kthim të mjeteve në para ose privilegje tjera, në kundershtim me nenin 55 paragrafi (2) të ketij ligji;

15) arketon kompensime në kundershtim me nenin 57 të ketij ligji;

16) nuk e kryen pagesen e pare të anuitetit në afatin e percaktuar në nenin 74 paragrafi (3) të ketij ligji;

17) nuk e harmonizon proporcionalisht shumen e anuitetit në menyre të percaktuar me nenin 75 të ketij ligji dhe

18) kryen pagese të anuiteteve në kundershtim me nenin 78 paragrafi (2) të ketij ligji.

(2) Gjore në shume prej 1 000 deri në 2 000 euro në kundervlere me denare, do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në shoqeri për sigurim për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 84

(1) Gjore në shume prej 30 000 deri në 40 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje shoqerise për sigurim, nese:

1) paguan lloj të pensionit nga shtylla e dyte ose kompensim pensional nga shtylla e trete, në kundershtim me nenet 3 dhe 52 të ketij ligji;

2) nuk shfrytezon tabela të mortalitetit në pajtim me nenin 22 paragrafi (2) të ketij ligji;

3) nuk shfrytezon shkalle të kamates në pajtim me nenin 22 paragrafi (6) të ketij ligji;

4) nuk shfrytezon tabela të mortalitetit në pajtim me nenin 63 paragrafi (2) të ketij ligji dhe

5) nuk shfrytezon shkalle të kamates neni 63 paragrafi (6) të ketij ligji.

(2) Gjore në shume prej 3 000 deri në 4 000 euro në kundervlere me denare, do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në shoqerine për sigurim për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 85

(1) Gjore në shume prej 2 000 deri në 4 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje shoqerise pensionale, nese:

1) nuk dorezon të dhena statistikore te MAPAS-i në periudhe dhe forme të percaktuar nga MAPAS-i, në pajtim me nenin 22 paragrafi (4) të ketij ligji;

2) nuk mban dhe ruan evidence në menyre të percaktuar në nenin 37 paragrafi (1) të ketij ligji;

3) nuk dorezon të dhena statistikore për MAPAS-in në periudhe dhe forme të percaktuar nga MAPAS-i, në pajtim me nenin 63 paragrafi (4) të ketij ligji dhe

4) nuk mban dhe ruan evidence në menyre të percaktuar në nenin 76 paragrafi (1) të ketij ligji;

(2) Gjore në shume prej 500 deri në 700 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni edhe personit pergjegjes në shoqaten pensionale.

Neni 86

(1) Gjore në shume prej 10 000 deri në 20 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje shoqerise pensionale, nese:

1) nuk cakton person që ka leje për pune si aktuar i autorizuar në pajtim me nenin 15 paragrafi (2) të ketij ligji;

2) gjate llogaritjes së pare për terheqje të programuara, shfrytezon parametra dhe formule në kundershkrim me nenin 16 paragrafet (2) dhe (4) të ketij ligji;

3) gjate llogaritjes së perseritur për terheqje të programuara, shfrytezon parametra dhe formule në kundershkrim me nenin 16 paragrafi (3) dhe (4) të ketij ligji;

4) arketon kompensime në kundershkrim me nenin 17 paragrafi (1) të ketij ligji;

5) nuk kryen kontroll të shumës së pensionit në pajtim me nenin 20 paragrafi (5) të ketij ligji;

6) nuk parashtron kerkese për kuotizacion në pajtim me nenin 29 paragrafi (3) të ketij ligji;

7) nuk prezanton oferte në afatin e percaktuar në nenin 30 paragrafi (1) të ketij ligji;

8) nuk dorezon tabele permbledhese në pajtim me nenin 32 paragrafi (1) të ketij ligji;

9) arketon kompensime për bartje të mjeteve në kundershkrim me nenin 36 paragrafit (1) të ketij ligji;

10) nuk i bart mjetet në afatin e percaktuar në nenin 36 paragrafi (2) të ketij ligji;

11) nuk e njofton fondin e SIPM-it në pajtim me nenin 38 paragrafi (1) të ketij ligji;

12) nuk kryen kontroll të lartesisë së pensionit nga shtylla e dyte në pajtim me nenin 39 paragrafi (2) të ketij ligji;

13) nuk kryen kontrolle në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) të ketij ligji;

14) nuk e rrit pagesen e terheqjeve të programuara në pajtim me nenin 42 paragrafi (1) të ketij ligji;

15) kryen pagese të terheqjeve të programuara në kundershkrim me nenin 49 paragrafi (1) të ketij ligji;

16) nuk e kryen zvogelimin e tatimit gjate pageses së pensioneve nga shtylla e dyte dhe kompensimeve pensionale nga shtylla e trete, në pajtim me nenet 50 dhe 79 të ketij ligji;

17) nuk parashtron kerkese për kuotizacion në pajtim me nenin 67 paragrafi (7) të ketij ligji;

18) nuk prezanton oferta në pajtim me nenin 69 të ketij ligji;

19) nuk prezanton tabele permbledhese në pajtim me nenin 71 paragrafi (2) të ketij ligji;

20) kryen bartje të mjeteve nga llogaria individuale vullnetare ose llogaria profesionale te subjekti që nuk eshte shoqeri për sigurim ose shoqeri pensionale, në kundershkrim me nenin 74 paragrafi (1) të ketij ligji;

21) nuk kryen bartje të mjeteve në afatin e percaktuar në nenin 74 paragrafi (2) të ketij ligji;

22) nuk e kryen pagesen e pare të terheqjeve të programuara në afatin e percaktuar në nenin 74 paragrafi (3) të ketij ligji dhe

23) kryen pagese të terheqjeve të programuara në kundershkrim me nenin 78 paragrafi (1) të ketij ligji.

(2) Gjobe në shume prej 1 000 deri në 2 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në shoqerine pensionale për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 87

(1) Gjobe në shume prej 30 000 deri në 40 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje shoqerise pensionale, nese:

1) paguan lloj të pensionit nga shtylla e dyte ose kompensim pensional nga shtylla e trete, në kundershtrim me nenet 3 dhe 52 të ketij ligji;

2) nuk shfrytezon tabela të mortalitetit në pajtim me nenin 22 paragrafi (3) të ketij ligji;

3) nuk shfrytezon shkalle të kamates në pajtim me nenin 22 paragrafi (7) të ketij ligji;

4) nuk shfrytezon tabela të mortalitetit në pajtim me nenin 63 paragrafi (3) të ketij ligji dhe

5) nuk shfrytezon shkalle të kamates neni 63 paragrafi (7) i ketij ligji.

(2) Gjobe në shume prej 3 000 deri në 4 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në shoqeri pensionale për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 88

(1) Gjobe në shume prej 5 000 deri në 10 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje shoqerise për perfaqesimin në sigurim ose e shoqerise brokere të sigurimit, nese:

1) ofron zbritje, kthim të mjeteve në para ose privilegje tjera në kundershtrim me nenin 7 paragrafi (2) të ketij ligji;

2) arketon provizion nga shoqeria për sigurim në kundershtrim me nenin 8 paragrafi (2) të ketij ligji dhe

3) ofron zbritje, kthim të mjeteve në para ose privilegje tjera në kundershtrim me nenin 55 paragrafi (2) të ketij ligji.

(2) Gjobe në shume prej 500 deri në 1 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet edhe personit pergjegjes në shoqerine për perfaqesimin në sigurim ose shoqerise brokere të sigurimit dhe perfaqesuesit në sigurim për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 89

(1) Gjobe në shume prej 10 000 deri në 20 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje shoqerise pensionale, nese:

1) nuk dorezon kopje të aktvendimit perkatesisht vendimit në shoqerine pensionale në pajtim me nenin 28 paragrafet (2) dhe (3) të ketij ligji;

2) nuk kryen kontroll të dallimit të llogaritur deri në shumen më të vogel të pensionit, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të ketij ligji;

3) nuk kryen pagese të dallimit deri në shumen më te vogel të pensionit në pajtim me nenin 41 paragrafi (3) të ketij ligji;

4) nuk kryen pagese të dallimit të pensionit në pajtim me nenin 42 paragrafi (2) të ketij ligji dhe

5) Nuk kryen pagese të shumes më të vogel të pensionit në pajtim me nenin 43 paragrafi (1) të ketij ligji.

(2) Gjobe në shume prej 1 000 deri në 2 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni edhe personit pergjegjes në Fondin e Sigurimit Pensional Invalidor të Maqedonise.

(3) Organ kompetent për shqiptimin e sanksioneve për kundervajtje nga paragrafi (1) të ketij neni eshte gjykata kompetente.

Pjesa V

Kreu 22

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 90

Shoqeria pensionale e themeluar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të caktoje person për llogaritje dhe pagese të pensioneve dhe kompensimeve pensionale përmes terheqjeve të programuara, para fillimit të pageses së terheqjeve të programuara për shfrytëzues të pensionit ose kompensimit pensional.

Neni 91

(1) Qendra për Kuote do të themelohet në afat prej tre muajsh nga dita e leshimit të lejes së pare për kryerje të punëve të sigurimit në klasen e anuiteteve dhe paguan anuitete për shfrytëzues të pensionit.

(2) Deri në themelimin e Qendres për Kuote, grumbullimin dhe prezantimin e ofertave për pensione nga shtylla e dyte, do të kryhet nga shoqeria pensionale që menaxhon me fondin pensional ku anetari ka llogari individuale. Shoqeria pensionale detyrohet që të vendose menyre elektronike për komunikim me të gjitha shoqerite pensionale me qellim që të grumbulloje oferta dhe të kryejë punë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 92

Aktet nenligjore miratimi i të cilave parashihet me kete ligj do të miratohen në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 93

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga 1 marsi 2014.